



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

#

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Janar-Dhjetor 2013#

Prishtinë, 2014

Përmbajtja

Fjala e Ministrit	4
Hyrje	6
Përmbledhje e përgjithshme	7
I. FUNKSIONIMI I KOMUNAVE	10
1. Kuvendi i Komunës	10
1.1. Komitetet e Kuvendit të Komunës	12
1.2. Aktet e kuvendeve të komunave	15
1.2.1. Rregulloret dhe vendimet e miratuara në Kuvendet e Komunave	15
1.2.2. Llojet e akteve të miratuara	16
1.3. Pjesëmarrja dhe raportimi i kryetarit të komunës	17
1.4. Takimet publike me qytetarë	18
1.5. Ueb-faqet zyrtare të komunave	19
1.6. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi	21
1.7. ZGJEDHJET LOKALE DHE KONSTITUIMI I ORGANEVE TË KOMUNAVE	23
1.7.1. Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve lokale	23
1.7.2. Zgjedhja e kryetarëve të komunave dhe certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve	23
1.7.3. Konstituimi i kuvendeve të komunave pas zgjedhjeve lokale	24
1.8. MBIKËQYRJA E KOMUNAVE	25
1.8.1. Dërgimi i akteve për shqyrtim të ligjshmërisë	25
1.8.2. Shkeljet ligjore të evidentuara	25
1.8.3. Kërkesat e organit mbikëqyrës për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme të kuvendeve të komunave	26
1.8.4. Harmonizimi i akteve sipas rekomandimit të MAPL-së	26
1.8.5. Harmonizimi i akteve sipas rekomandimit të komisioneve sektoriale	27
1.8.6. Aktet e kundërligjshme të rishqyrtuara nga kuvendet e komunave dhe të paharmonizuara me rekomandimet e organit mbikëqyrës	27
1.8.7. Shkeljet ligjore të konstatuara nga MAPL, të cilat nuk janë rishqyrtuar në kuvendet e komunave edhe pas shkresës për rishqyrtim	27
II. PERFORMANCA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	29
2.1. Shërbimet Administrative	29
2.2. Mirëqenia Sociale dhe Familjare	30
2.3. Kulturë, Rini dhe Sport	31
2.4. Emergjencat Lokale	33
2.5. Planifikimi Urban	34
2.6. Parqet dhe sheshet	35
2.7. Rrugët	36
2.8. Trotualet	37
2.9. Transporti Publik komunal	38
2.10. Parkingjet publike	39
2.11. Ndriçimi Publik	40
2.12. Furnizimi me ujë	41
2.13. Kanalizimi	42
2.14. Grumbullimi i Mbeturinave	43
2.15. Deponimi i Mbeturinave	44

III. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT KOMUNAL PËR NEGOCIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT JANAR – DHJETOR 2013	45
3.1. Kriteret politike	45
Komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë informacion për numrin e trajnimeve janë: Fushë-Kosova, Gjakova, Gillogovci, Istogu, Rahoveci, Suhareka, Hani i Elezit, Mamusha, Kllokoti, Parteshi, Ranillugu dhe Graçanica.	46
3.2. Të drejtat e njeriut	47
3.2.1. Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJDNUK)	47
3.2.2. Barazia gjinore	47
3.2.3. Dhuna në familje	49
3.2.4. Të drejtat e komuniteteve	50
3.2.5. Përdorimi i gjuhëve	51
3.2.6. Të drejtat e fëmijëve	51
3.2.7. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	53
3.3. Aftësia për të përballur obligimet që dalin nga MSA	54
3.3.1. Kthimi dhe riintegrimi	54
3.3.2. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	56
3.4. Bujqësia	57
3.5. Kontrolli financiar	58
3.6. Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik	59
3.7. Mjedisi dhe ndryshimet klimatike	62
3.8. Bashkëpunimi ndërkomunal	64
IV. FINANCAT LOKALE	69
4. Shpenzimet e buxheteve komunale për vitin 2013	69
4.1. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin	69
4.2. Realizimit të hyrave vetanake për vitin 2013	71
4.2.1. Mbledhja e të hyrave vetanake krahasuar me planifikimin	71
4.3. Opinionet e auditimit për komunat e Republikës së Kosovës për vitet 2011 dhe 2012 si kusht për huamarrjen komunale	72
4.3.2. Përkufizimet e opinioneve sipas ISSAI 400 - Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit 400).	73
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	74
SHTOJCA 1. AZHURITETI DHE EFIKASITETI I ORGANEVE TË KOMUNAVE	77
SHTOJCA 2: Tabela e publikimit të akteve komunale në faqet zyrtare elektronike të komunave	96
SHTOJCA 3.	101
Tabela e shpenzimeve vjetore të buxheteve komunave për vitin 2013	101
SHTOJCA 4:	111
-Tabela e realizimit të të hyrave vetanake për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012	111
-Inkasimi i të hyrave vetanake krahasuar me planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2013	112
-Tabela e realizimit të të hyrave direkte dhe të hyrave indirekte për vitin 2013	113
-REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE TE KOMUNAVE SIPAS STRUKTURËS PËR VITIN 2013	116
SHTOJCA 5. Opinionet detaje te Auditorit Gjeneral sipas komunave për vitet 2011-2012	118
Referencat	132

Fjala e Ministrit

Të nderuar lexues,

Vetëqeverisja lokale në Kosovë në vazhdimësi është duke përparuar. Ky sistem i vetëqeverisjes është i bazuar kryesisht në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, si dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar që përcakton parimet e funksionimit të vetëqeverisjes lokale. Kosova ka kaluar në një proces të rëndësishëm të reformimit të vetëqeverisjes lokale dhe rezultatet janë evidente.

Tani më përfundimisht, duke u bazuar në legjislacionin bazë për vetëqeverisje lokale, është krijuar një përvojë e mirë e ushtrimit të pushtetit në nivelin lokal, janë barë hapa për nxjerrjen e legjislacionit sekondar për vetëqeverisje lokale, si dhe është arritur që pushteti lokal i bazuar në sistemin ligjor të shtrihet në të gjitha komunat e Kosovës.

Roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është i orientuar në fuqizimin e komunave për menaxhimin e kompetencave të tyre, krijimin e kushteve për një sistem efikas të vetëqeverisjes lokale në përputhje me nevojat e qytetarëve, duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe jetësuar parimin e subsidiaritetit.

Zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2013 sollën një frymë të re të zhvillimeve demokratike, e sidomos në sistemin zgjedhor. Vullneti i përgjithshëm i sovranit bëri të ketë ndryshime të shumta në përbërjen e kuvendeve dhe kryetarëve të komunave. Ndryshe nga përbërjet e kaluara, ku kryetarët kishin shumicën edhe në kuvendet e komunave, tani në pjesën më të madhe të komunave struktura e përfaqësimit është e ndryshme, si rezultat i përfshirjes së një numri të subjekteve të reja politike që morën pjesë në zgjedhje lokale për të parën herë. Një formë e tillë e përfaqësimit e forcon demokracinë lokale, e bënë më atraktiv pushtetin lokal, i kontribuon llogaridhënies, forcon kontrollin e organeve komunale dhe rritë efikasitetin e qeverisjes në zhvillimin dhe zbatimin e politikave lokale që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve publike të qëndrueshme dhe sa më cilësore.

Gjatë periudhës 4 vjeçare, është forcuar bashkëpunimi mes nivelit qendror dhe atij lokal. MAPL ka avancuar me sistemin e monitorimit dhe të asistencës për organet komunale. Ky sistem mundësoi një monitorim shumë më efikas, me resurse të njëjta, duke kursyer mjete dhe kohë. Mbikëqyrja e komunave solli sigurimin e ligjshmërisë me rastin e nxjerrjes së akteve komunale. Po ashtu, përmes konsultimit paraprak u mundësua një preventivë e mirë në rastet kur komunat mund të miratonin akte jo të ligjshme.

Komunat duhet të vazhdojnë të punojnë edhe më ngushtë me autoritetin mbikëqyrës, me qëllim të garantimit të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit, duke promovuar demokracinë e drejtëpërdrejtë, në përputhje me nevojat e përgjithshme dhe në funksion të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Prandaj ky raport që po e publikojmë është një dokument shumë i rëndësishëm, për Kryetarët, Kuvendet e Komunave, organizatat publike e jopublike, dhe qytetarët ta përdorin për avancimin dhe modernizimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Të gjeturat, analizat dhe rekomandimet në këtë raport duhet të shërbejnë si

burim i pazëvendësueshëm i informacionit për formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve për të ecur së bashku përpara dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike për qytetarët e vendit tonë dhe për të afirmuar vetëqeverisje lokale në rajon dhe më gjerë.

Në fund, unë dua që të falënderojë të gjithë ata që kontribuan që të marrim këto rezultate, stafin që ka punuar në raport dhe publikun për vëmendjen që i ka kushtuar këtij segmenti të rëndësishëm të jetës institucionale e publike në Kosovë.

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal harton rregullisht raportin për funksionimin e komunave, duke vlerësuar progresin e komunave drejt përmbushjes së obligimeve ligjore, zbatimin e kompetencave të tyre, si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësisë që lidhen me realizimin e kërkesave dhe interesave të qytetarëve.

Ky raport ndjek një strukturë tjetër në krahasim me raportet e viteve paraprake:

- Raporti përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Shkurtimeisht paraqet rezultatet e zgjedhjeve lokale dhe procesin e konstituimit të organeve komunale;
- Analizon të dhënat e performancës dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimeve komunale, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, si dhe nivelin e shpenzimeve.
- Shqyrton hapat e komunave që dalin nga Plani i Veprimit për Negociimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit;
- Paraqet të dhënat për shpenzimet buxhetore të komunave, planifikimin e të hyrave dhe realizimin e tyre;
- Ofron opinionet e auditorit gjeneral për pasqyrat financiare të komunave dhe zbatimin e procedurave;

Raporti përfshinë periudhën nga janari deri në fund të dhjetorit 2013. Përfshijmë pjesë të opinionëve të auditorit gjeneral që jep vlerësimet për vitin 2011-2012.

Progresi i komunave matet përmes nivelit të zbatimit të kriterëve të përcaktuara me ligj, performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve, krahasimin mes komunave, nivelin e respektimit të ligjshmërisë, zbatimin e procedurave ligjore, aktiviteteve të ndërmarra, cilësisë së vendimeve të komunave si dhe masave për zbatimin e kërkesave dhe rekomandimeve të organit mbikëqyrës.

Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të analizuar nga Departamentet përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Gjithashtu, janë përdorur edhe burime të tjera, duke përfshirë përgjigjet e zyrtarëve komunal në pyetjet e parashtruara, të dhënat nga Auditori Gjeneral, të dhënat nga Ministria e Administratës Publike, si dhe të dhënat e siguruar nga monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr konkluzione të detajuara lidhur me funksionimin e organeve komunale dhe hapave të cilët komunat duhet ndërmarrin në të ardhmen.

Përmbledhje e përgjithshme

Zgjedhjet lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2013 sollën ndryshime në organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Këto zgjedhje ishin të dytat me mandatin e plotë prej 4 viteve, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Zgjedhjet Komunale. Pas mbajtjes së zgjedhjeve, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë konstituuar organet komunale.

Deri në vitin 2013 kanë qenë funksionale 34 komuna. Gjatë kësaj periudhe, 5 kuvende të komunave kanë mbajtur më pak mbledhje se kriteri minimal i paraparë ligjor. Komunitetet kanë krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e kompetencave të tyre, duke ndërtuar një sistem të mirë të qeverisjes dhe në përputhje me nevojat e përgjithshme të qytetarëve. Për të plotësuar sfondin e nevojshëm normativ, komunat kanë siguruar nxjerrjen e akteve të obligueshme juridike të cilat në mënyrë shprehimore kërkojnë nga legjislacioni në fuqi. Megjithatë ende ka nevojë për t'u bërë, e sidomos në menaxhimin e mirë të financave, menaxhimin e qëndrueshëm të pronës komunale, ushtrimin e mirë të funksioneve të kuvendit dhe ekzekutivit të komunës, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Komitetet e obligueshme kanë funksionuar në të gjitha komunat. Përfshirë Komitetin për Komunitete në Komunën e Kaçanikut nuk ka qenë funksional, por duhet rritur kursin në komunat: Obiliq, Hani i Elezit, Rahovec dhe Mitrovicë. Janë themeluar 49 Komitete të veçanta për fushat e ndryshme të veprimtarisë së komunave, si: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Arsime dhe Kulturë; Zhvillim Ekonomik; Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të mjedisit. Ndërsa, sa u përket mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë, janë themeluar 23 komitete konsultative.

Komunitetet kanë avancuar në zbatimin e normave që sigurojnë transparencën në punën e organeve komunale. Në të gjitha rastet, kuvendet e komunave kanë qenë të hapura për publikun. Megjithatë, është parë mosprezenca e qytetarëve në mbledhjet e kuvendeve dhe në takimet publike të organizuara ekskluzivisht për ta. Në komuna janë mbajtur gjithsej 51 takime me qytetarë të cilat sipas nenit 68.1 të LVL-së parashihen të mbahen së paku dy herë në vit. Këto normë e kanë përmbushur 18 komuna, derisa 16 të tjera kanë mbajtur vetëm nga një takim me qytetarë të karakterit të tillë. Por është e rëndësishme të theksohet se komunat kanë organizuar takime të tjera me qytetarë me rastin e draftimit të akteve, planeve dhe dokumenteve të tjera zyrtare, të cilat janë mbajtur në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Sfidë mbetet funksionalizimi i ueb-faqeve zyrtare. Pjesa më e madhe e komunave nuk i kanë azhurnuar me rregull ueb-faqet komunale me dokumentet zyrtare, siç janë: rregulloret, vendimet, planet dhe raportet e ndryshme.

Sa i përket raportimit, kryetarët e komunave duhet rritur numrin e raportimeve para kuvendeve të komunave. Kjo për shkak se pothuajse gjysma e tyre nuk kanë raportuar mjaftueshëm para kuvendeve për situatën ekonomiko-financiare të komunave dhe zbatimin e planeve investuese. Në tërësi janë bërë 58 raportime të kryetarëve të komunave, nga të cilat 19 kryetarë kanë respektuar normën prej 2 raportimeve gjatë vitit, ndërsa 14 të tjerë kanë raportuar vetëm nga një herë, kurse në Ferizaj nuk është raportuar asnjë herë.

Në disa komuna mbetet problem çështja e dërgimit paraprak të materialeve të rendit të ditës së mbledhjeve të kuvendit (Juniku, Rahoveci, Deçani, Mamusha dhe Dragashi), të cilat nuk kanë respektuar nenin 43.3 të LVL-së. Këto komuna paraprakisht nuk i kanë bërë të njohura projekt-vendimet, projekt-rregulloret, planet e ndryshme ose shënimet e nevojshme për çështjet e caktuara, ose këto dokumente i kanë dërguar vetëm pjesërisht. Për arsye të ndryshme, janë evidentuar raste të lëshimit (bojkotimit) të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave si në: Gjiilan, Istog, Prizren, Podujevë, Malishevë dhe Shtime.

Komunat janë kompetente edhe në çështjet për sigurinë publike. Përkundër normimit të kriterëve bazë për funksionalizimin e KKS-vë, në institucionet e nivelit lokal të qeverisjes ende mungon vetëdija e përgjithshme për rëndësinë e këtij mekanizmi. Në përgjithësi, intensiteti i punës së KKS-vë gjatë vitit 2013 vlerësohet në rënie.

Sa u përket mekanizmave për të drejtat e komuniteteve, ato janë të themeluara, mirëpo pengesë mbetet decentralizimi i fondit për ri-integrim. Procedurat për realizimin e kërkesave të të riadhesuarve vlerësohen të jenë mjaft burokratike. Lidhur me veprimet juridike të komunave në përfshirjen e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, në bazë të shqyrtimit të ligjshmërisë së Statuteve të Komunave është evidentuar se një pjesë e komunave duhet të inkorporojnë ZKK-në në Statutet e tyre dhe të harmonizojnë pozitat e zyrtarëve konform Rregullores Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Komunat kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Në tërësi janë miratuar 1109 vendime dhe 149 rregullore. Lidhur me menaxhimin e pronës së paluajshme të komunës, kuvendet e komunave kanë nxjerrë 44 vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajshme komunale, ndërsa 13 vendime për këmbimin e pronës komunale me personat fizik dhe juridik.

Numri i përgjithshëm i akteve të kundërligjshme të nxjerra nga Kuvendet e Komunave është 59. Prej tyre, komunat kanë rishqyrtuar 39 akte ose 66%, ku 27 janë harmonizuar me vërejtjet e organit mbikëqyrës ose 69%, ndërsa 12 vendime ose 30%, edhe pas rishqyrtimit nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesat e organit mbikëqyrës. Krahas tyre 20 akte nuk janë rishqyrtuar fare, ose në përqindje 33%.

Efikasiteti i administratës së komunave është matur përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale. Komunat tashmë kanë krijuar një përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e të dhënave përmes këtij sistemi. Të dhënat për azhuritimin janë siguruar nga platforma e përbashkët elektronike CSC/CMS. Për komunat menaxhimi i këtyre të dhënave duhet avancuar. Komunat janë të obliguara për përdorimin e kësaj platforme të përbashkët elektronike. E gjithë kjo paraqet një përparësi të madhe për komunat dhe MAPL-në, në kuptimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, evidentimin e të gjitha transaksioneve të bëra nga ana e komunave dhe njëkohësisht raportimin shumë të lehtë të këtyre të dhënave.

Komunat me performancën më të mirë të treguar në ofrimin e shërbimeve kanë qenë përfituese të fondit stimulues.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale rregullon të drejtën që Komunat e Kosovës të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale. Krahasuar me vitin 2012, në vitin 2013 ka pasur rritje të buxhetit të komunave për 16,034,695.11€ ose 3.96% si rezultat i rritjes së grantit të përgjithshëm (në vitin 2013 - 421,340,178.99€, ndërsa vitin 2012 - 405,305,483.88€). Sa i përket shpenzimeve të buxhetit, Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2013 kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 381,718,461.61€ ose 91% e buxhetimit në vlerë prej 421,340,178.99€. Gjithashtu, planifikimi i të hyrave vetanake në vlerë prej 63,394,000.00€ për vitin 2013, krahasuar me vitin 2012 në vlerë prej 60,419,000.00€, është më i madh për 2,975,000.00€. Kurse, mbledhja e të hyrave vetanake për vitin 2013 në vlerë prej 52,172,402.27€, krahasuar me vitin 2012 në vlerë prej 55,819,658.62€, është më i vogël për 3,647,256.35€ ose një ulje prej 10%. Njëri ndër faktorët kryesor në uljen e inkasimit të të hyrave ka qenë heqja e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve.

Opinionet e auditorit kanë qenë të ndryshme dhe dallojnë sipas viteve. Opinioni i cili më së shumti është dhënë në vitet 2011 - 2012 është Opinioni pa rezerve (i pa kualifikuar) me

theksim të çështjes. Ky opinion i është dhënë 20 komunave. Krahas tij, në 14 komuna është dhënë opinionimi me theksim të çështjes, opinionimi me rezervë në 11 komuna, opinionimi pa rezervë në 8 komuna, opinionimi me rezervë me theksim të çështjes në 7 komuna, mohim të opinionit kanë marr 6 komuna dhe bazë për një opinion me rezervë me theksim të çështjes ka marr 1 komunë.

Në janar të vitit 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka publikuar Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit, pas konfirmimit të Këshillit të Bashkimit Evropian (datë 11 dhjetor të vitit 2012) se Kosova do të fillojë negociatat për MSA-në për shkak të përmbushjes së kriterëve. Duke e ditur se Republika e Kosovës ka hyrë në një fazë të re të integriteteve evropiane, mobilizimi i institucioneve qendrore dhe atyre lokale ka qenë i menjëhershëm në koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky plan.

Komunat kanë qenë të obliguara të raportojnë për veprimet që dalin nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. MAPL, ka dërguar pyetësorin për plotësim i cili është nxjerrë nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit. Në këtë drejtim, një pjesë e konsiderueshme e komunave të Republikës së Kosovës kanë raportuar për periudhën janar-dhjetor 2013. Është vërejtur se mënyra e raportimit të komunave në dhënien e përgjigjeve është mikse, ku një pjesë e përgjigjeve janë konkrete, pjesa tjetër e përgjigjeve i takon mënyrës së përgjithësuar, ndërkaq në pjesën tjetër nuk ka fare përgjigje.

Sipas të dhënave, rezulton një avancim i të drejtave të njeriut në komuna, por ende mungon priorizimi i tyre në agjendën politike të komunave. Prioritet dhe vëmendje e veçantë i është kushtuar barazisë gjinore. Angazhimi i zyrtarëve për barazi gjinore ka ndikuar në avancimin e pozitës së gruas në të gjitha sferat e jetës, avancimin e saj në pozita vendimmarrëse dhe fuqizimin e saj ekonomik. Gjithashtu, prioritet i komunave mbetet integrimi i komuniteteve, me theks të veçantë komunitetit serb dhe RAE. Vërehet një lëvizje pozitive në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara. Tanimë në komuna funksionojnë 35 NJDNJK, duke përfshirë edhe zyrën administrative të Mitrovicës së Veriut, me burime adekuate njerëzore. Këto Njësi veprojnë si mekanizma të qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal

I. FUNKSIONIMI I KOMUNAVE


Ky seksion përmbledhë mënyrën e funksionimit të organeve të komunave të Republikës së Kosovës drejt përmbushjes së obligimeve ligjore që derviojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë kompetencat e nivelit lokal të qeverisjes. Po ashtu, monitoron elementet kryesore të funksionimit të kuvendeve, përmbajtja e të cilave garanton qëndrueshmërinë e organeve komunale, respektimin e procedurave ligjore, respektimin e ligjshmërisë, efikasitetin, transparencën, bashkëpunimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin.

1. Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i pushtetit lokal dhe njëkohësisht organi mbikëqyrës i autorizuar ligjërisht për sigurimin e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të ushtruar funksionin e tij, kuvendi i komunës duhet të mblidhet rregullisht në mënyrë që të kryej përgjegjësitë në kuadër të kompetencave komunale, për të miratuar aktet e nevojshme normative për funksionimin e komunës, akte të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi apo ato të cilat ligjet i lënë të hapura për tu nxjerrë varësisht nga nevojat e komunave, si dhe për të diskutuar dhe vendosur çështjet me interes të komunës.

Korniza ligjore për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës ka përcaktuar disa kriterë në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të organeve komunale. Në lidhje me këtë, me LVL janë vënë rregulla që i referohen mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës për të siguruar njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit¹.

Në tërësi, 34 kuvende të komunave kanë mbajtur 333 mbledhje të rregullta dhe 41 të jashtëzakonshme të kuvendeve të komunave. Të dhënat për numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave janë si në vijim:



Histogrami nr.1. Mbledhjet e kuvendeve të komunave gjatë periudhës janar-dhjetor 2013

Përkundër planifikimit të agjendës vjetore të mbledhjeve të kuvendeve me planet e punës, histogrami i mësipërm tregon se 5 kuvende të komunave kanë dështuar në mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit, siç është rasti me: Deçanin, Mamushën, Parteshin, Skënderajin dhe Vitinë.

Pjesa më e madhe e mbledhjeve të jashtëzakonshme janë mbajtur me qëllim të rishikimit buxhetor të komunave, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave të datës 5 qershor 2013 dhe afatit të përcaktuar për dorëzim deri më datën 12 qershor 2013.

¹ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.


Në të gjitha rastet, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, por interesimi i qytetarëve nuk është parë të jetë i shprehur. Nga ana tjetër, edhe pse dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për arsye specifike lejojnë që komunat të përjashtojnë opinionin nga mbledhjet e kuvendit, deri tani nuk është marrë ndonjë vendim nga kuvendet e komunave për përjashtim të publikut.

Sipas rregullave procedurale, para mbajtjes së takimeve të kuvendit, komunat janë të obliguara të njoftojnë me kohë anëtarët e kuvendit për kohën e mbajtjes së mbledhjeve, varësisht se a është fjala për mbledhje të rregullt apo të jashtëzakonshme. Në lidhje me këtë, ka pasur raste kur nuk janë respektuar afatet ligjore për dërgimin e ftesave të mbledhjeve tek anëtarët e kuvendit të komunës. Kjo është evidentuar sidomos me rastin e thirrjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme në komunat: Ferizaj, Prizren, Shtime, Kaçanik, Istog, Deçan, Hani i Elezit, Pejë, Kamenicë, Dragash, Klinë, Podujevë dhe Fushë-Kosovë, të cilat njoftimin e kanë bërë me vonesë, pra jo në afatin ligjor prej 3 ditësh pune ashtu siç kërkohet. Efektet e këtyre vonesave kanë nxitur reagime, derisa ka ardhur te dështimi i mbledhjes së jashtëzakonshme në Kuvendin e Komunës së Istogut.

Të po kësaj natyre janë disa raste kur komunat kanë dështuar që bashkë me agjendën dhe ftesën, MAPL-së t'i dorëzojnë edhe materialet e punës para mbledhjes së kuvendit, siç është rasti në: Junik, Rahovec, Deçan, Mamushë dhe Dragash. Për dallim nga to, në Komunat: Graçanicë, Ranillug, Shtërpcë, Kllokot dhe Partesh, janë paraqitur vështirësi me rastin e dërgimit të akteve në gjuhët zyrtare, për shkak të numrit të kufizuar të zyrtarëve për përkthim. Për këtë, MAPL ka dërguar shkresë në të gjitha komunat duke i'u komunikuar obligimet e tyre ligjore ndaj autoritetit mbikëqyrës për njoftimin me kohë dhe përmbajtje të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Konform Planit të Monitorimit, kjo çështje është trajtuar edhe gjatë monitorimit të drejtpërdrejtë të komunave në muajin shkurt dhe tetor 2013. Trajtimi i kësaj komponente ka dhënë efektin pozitiv, sepse komunat kanë bërë avancim në këtë drejtim, duke respektuar rregullat e njoftimit për mbledhjet e kuvendit, si dhe duke shtuar kërkesat për konsultim paraprak përkitazi me agjendën e kuvendit. Për procesin e mbikëqyrjes elementi i informimit konsiderohet i rëndësishëm, pasi mundëson identifikimin paraprak të problemeve, për të cilat organi mbikëqyrës mund të ofroj konsultime për organet e vetëqeverisjes lokale dhe të parandaloj nxjerrjen e akteve të kundërligjshme.

Lidhur me ecurinë e mbledhjeve, gjatë periudhës raportuese për arsye të ndryshme janë evidentuar disa raste të lëshimit (bojkotimit) të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, si në: Gjilan, Istog, Prizren, Podujevë, Malishevë dhe Shtime.

Arsyet e mosmbajtjes dhe lëshimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave



Histogrami nr.2. Të dhënat për arsyet e mosmbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe lëshimit të tyre*

* Në Komunën e Gjilanit, mbledhja e kuvendit është braktisur nga njëri subjekt politik i përfaqësuar, për shkak të mospajtimit për të diskutuar dhe përfshirë në rendin e punës propozim-vendimin për kompensimin e dëmeve pronarëve gjatë implementimit të projektit në lumin "Mirusha". Ky propozim është bërë në fund të mbledhjes nga kryesuesi i kuvendit që paraqet shkelje të nenit

Siç shihet nga Histogrami 2, në komuna janë shënuar raste të lëshimit, bojkotimit dhe mospjesmarrjes në mbledhjet e kuvendit për arsytet e dhëna më sipër. Rastet e tilla duhet evituar në të ardhmen përmes marrjes së veprimeve konkrete nga komunat, duke përfshirë: respektimin e rregullave procedurale për hartimin dhe miratimin e rendit të ditës, respektimin e njoftimit me kohë për mbledhjet e kuvendit, marrjen parasysh të kërkesave dhe propozimeve të anëtarëve të kuvendit dhe trajtimin e tyre konform Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe respektimin e rregullave të debatimit.

1.1. Komitetet e Kuvendit të Komunës

Me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme për të mbështetur punën e tyre. Komunat janë të obliguara për të themeluar Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitete të përhershme. Si mundësi për të ushtruar më mire një fushë të caktuar të kompetencave komunale, kuvendi i komunës mund të themelojë komitete të tjera profesionale nëse e sheh të nevojshme dhe të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimit, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Për dallim nga to, Kuvendi i Komunës themelon edhe komitete konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Sa u përket komiteteve të obligueshme, ato kanë funksionuar në të gjitha komunat, me përjashtim të Komitetit për Komunitete në Komunën e Kaçanikut i cili nuk ka qenë funksional. Megjithatë, marrë parasysh numrin e takimeve, komiteti për komunitete duhet të përmirësojë punën në komunat: Obiliq, Hani i Elezit, Rahovec dhe Mitrovicë.

Sipas të dhënave, gjithsej janë mbajtur 305 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe 194 mbledhje të Komitetit për Komunitete (KK), siç tregojnë figura në vijim:

30.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës. Megjithatë, lëshimi i mbledhjes nga anëtarët e kuvendit nuk ka ndikuar në kuorum dhe mbledhja është zhvilluar normalisht.

Në *Komunën e Istogut*, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, dy subjekte politike të përfaqësuara kanë lëshuar mbledhjen për shkak të dërgimit me vonesë të ftesës për mbledhje. Mbledhja e kuvendit të kësaj komune është shtyer për një datë tjetër.

Në *Kuvendin e Komunës së Malishevës* mbledhja e planifikuar në muajin maj ka dështuar dy herë për shkak të mungesës së kuorumit.


Në *Kuvendin e Komunës së Podujevës* në mbledhjen e muajit mars është bojkotuar mbledhja nga opozita me arsyetimin se nuk është përfillë kërkesa e tyre për të shtyrë për mbledhjen e radhës shqyrtimin e Raportit financiar për vitin 2012 si dhe propozim-vendimit për përcaktimin në interes publik të një pjese të tokave të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës së Podujevës. Ky bojkot nuk ka pasur për pasojë ndërprerjen e mbledhjes pasi që nuk ka ndikuar në kuorum.

Një rast të lëshimit të mbledhjes ka pasur edhe në *Kuvendin e Shtimes* me datën 05.04.2013, pasi disa nga anëtarët e kuvendit kanë lëshuar mbledhjen me arsyetimin se nuk kanë kaluar propozimet e tyre për rendin e ditës.

Në *Kuvendin e Komunës së Prizrenit* ka pasur një rast të lëshimit të mbledhjes për shkak të mos përfshirjes në rendin e ditës të "Kërkesës për interpelancë të Drejtorit të Arsimit". Mbledhja është shtyrë si rezultat i mungesës së kuorumit pas lëshimit të saj.

Po ashtu, në *Kuvendin e Komunës së Prizrenit* mbledhja e jashtëzakonshme e planifikuar në muajin mars për shqyrtimin e gjendjes së arsimit fillor e të mesëm në Komunën e Prizrenit dhe debatit në mes të kuvendit dhe kryetarit të komunës ka dështuar për shkak të mungesës së kuorumit për mbajtje të mbledhjes.

Në *Kuvendin e Komunës së Kamenicës* është lëshuar mbledhja nga radhët e opozitës për shkak të mosdhënies së fjalës anëtarit të kuvendit dhe ndërhyrjes së kryetarit të komunës në punën e kuvendit. Megjithatë mbledhja është zhvilluar dhe lëshimi i mbledhjes nga subjekti opozitar nuk ka pasur ndikim në kuorum.




Histogrami nr.3. Numri i mbledhjeve të Komiteteve të Obligueshme

Duke marrë parasysh se Komiteti për Politikë dhe Financa është organ i përhershëm i Kuvendit të Komunës, përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve dhe çështjeve të buxhetit, rrjedhimisht puna e këtij komiteti përfaqëson edhe rekomandimet për kuvendin e komunës. Mbi bazën e kësaj, ky komitet takimet duhet t'i mbajë para mbledhjeve të kuvendit të komunës, duke marrë parasysh se agjenda e mbledhjeve është e përcaktuar kështu edhe me Rregulloret e Punës së Kuvendeve të Komunave. E njëjta gjë duhet të vlejë edhe për komunitetin për komunitete si mekanizëm për përfaqësimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Nëse krahasojmë numrin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete me mbledhjet e Kuvendit të Komunës, atëherë të dhënat tregojnë se nuk ka korelacion me tyre, siç shihet edhe nga figura e mëposhtme:

Dallimi i numrit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendeve të Komunave me mbledhjet e Komiteteve të përhershme




Histogrami nr.4. Të dhënat krahasuese mes mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të përhershme

Sipas të dhënave të histogramit të mësipërm, shohim se në 37 raste mbledhjet e kuvendeve të komunave janë zhvilluar pa mbajtjen paraprake të mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Ndryshe nga to, 148 mbledhje të kuvendeve të komunave janë zhvilluar pa mbajtjen paraprake të mbledhjeve të Komitetit për Komunitete. Nga kjo vërejmë se përveç shpërputhjes apo moskoordinimit të punës së komiteteve me kuvendet e komunave, intensiteti i punës së Komitetit për Komunitete ka qenë shumë më i ulët se sa i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në këtë llogaritje, nuk janë përfshirë 32 mbledhje inauguruese të kuvendeve të komunave të mbajtura në vitin 2013, pasi nuk kanë relevancë me mbledhjet e Komiteteve.

Në këtë vazhde është e rëndësishme të theksohet se një pjesë e komunave kanë themeluar edhe komitete të tjera në fusha specifike. Në tërësi janë themeluar 49 komitete të veçanta për fushat e ndryshme të veprimtarisë së komunave si: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Arsim dhe Kulturë; Zhvillim Ekonomik; Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të mjedisit. Megjithatë, në pak raste është vërejtur se këto komitete kanë shqyrtuar politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kanë kryer komitetet e përhershme.



Histogrami nr. 5. Të dhënat e për numrin e komunave të cilat kanë themeluar Komitete specifike në fusha të caktuara të kompetencave të tyre*

Krahas themelimit të komitete të tjera, komunat janë të obliguara të themelojnë edhe komitete konsultative. Kjo përgjegjësi është përmbushur në vetëm 8 komuna, dhe atë në: Istog, Mitrovicë, Vushtri, Hani i Elezit, Skenderaj, Lipjan dhe Ferizaj.

Në vijim është paraqitur skema e komiteteve konsultative të themeluara për sektorë të ndryshëm të fushëveprimtarisë në komuna:

* Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, 8 komuna kanë themeluar komitete të veçanta, siç janë: Peja, Prishtina, Deçani, Klina, Mitrovica, Obiliqi, Vushtrria, Gjilani dhe Malisheva. Për çështje të arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit janë themeluar Komitetet në 11 kuvende të komunave: Gjilan, Pejë, Lipjan, Istog, Prishtinë, Klinë, Malishevë, Glogovc, Mitrovicë, Obiliq, Vushtri; Në fushën e zhvillimit ekonomik, janë themeluar komitete në Kuvendet e Komunave: Prishtinë, Glogovc, Gjilan, Mitrovicë, Obiliq dhe Vushtri. Për planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit, janë themeluar komitete në këto komuna: Gjilan, Prishtinë, Deçan, Lipjan, Mitrovicë, Obiliq dhe Vushtri. Për shërbimeve publike, komitete të veçanta kanë themeluar: Gjilani, Prishtina, Peja, Klina, Shtimja, Mitrovica dhe Obiliqi. Për çështjet pronësore, kadastër dhe banim, komitete të veçanta kanë themeluar kuvendet e komunave: Gjilan dhe Prishtinë. Në fushën e drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe barazisë gjinore, komitete të veçanta janë themeluar në: Gjilan, Glogovc, Mitrovicë, Obiliq, Vushtri, Prizren dhe Suharekë. Krahas tyre, në Komunën e Malishevës është themeluar Komiteti për Diasporë dhe Komiteti për familje të Dëshmorëve, Invalid të Luftës; Në Komunën e Fushë Kosovës është themeluar Komiteti për Ndërmjetësim; Në Komunën e Prizrenit - Komiteti për trashëgimi kulturore të qytetit të Prizrenit; Në Komunën e Lipjanit – Komiteti për Bujqësi dhe Komiteti për çështje qytetare.



Histogrami nr. 6. Të dhënat për numrin e komunave të cilat kanë themeluar Komitete Konsultative në fusha të caktuara të kompetencave të tyre

Siç vërejmë, në 8 komuna janë themeluar 23 komitete konsultative. Prej tyre, në fushën e Urbanizmit, Pronës, Gjeodezisë, Kadastrit, Mbrojtje të Mjedisit, këto komitete janë themeluar në komunat: Ferizaj, Istog, Mitrovicë, Vushtri, Hani i Elezit; Për sektorin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë themeluar në komunat: Hani i Elezit, Vushtri, Skenderaj, Mitrovicë, Ferizaj; Në çështjet e shërbimeve publike dhe emergjencës janë themeluar në komunat: Hani i Elezit, Mitrovicë dhe Lipjan; Për shëndetësi dhe mbrojtje sociale, janë themeluar në: Vushtri, Mitrovicë dhe Ferizaj; Në fushën e zhvillimit ekonomik, janë themeluar në: Ferizaj, Skenderaj, Vushtri; Për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore janë themeluar në: Vushtri dhe Ferizaj; Për persona me aftësi të kufizuara është themeluar komiteti konsultativ në Komunën e Ferizajt; Gjithashtu në Komunën e Ferizajt është themeluar Komiteti konsultativ për kategoritë e dala nga lufta.


1.2. Aktet e kuvendeve të komunave

Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës është miratimi (nxjerrja) i vendimeve dhe rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Gjithashtu, kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, merr vendime, nxjerr rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët (e komuniteteve), si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës.

1.2.1. Rregulloret dhe vendimet e miratuara në Kuvendet e Komunave

Komunat kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Aktet e nxjerra rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret janë: miratimi i planeve rregulluese urbane, miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike, akteve të karakterit financiar siç janë Rregulloret për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, rishikimin buxhetor, akte të cilat promovojnë zhvillimin ekonomik lokal etj.

Nga aspekti numerik, në periudhën janar-dhjetor 2013, janë miratuar 1109 Vendime dhe 149 Rregullore.



Histogrami nr.7. Numri i Rregulloreve dhe Vendimeve të miratuara në Kuvendet e Komunave, janar-dhjetor 2013.

Pasqyra e të dhënave numerike për aktet e miratuara tregon se numrin më të madh të Rregulloreve e ka miratuar Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, derisa numrin më të madh të vendimeve, Kuvendi i Komunës së Graçanicës.

1.2.2. Llojet e akteve të miratuara

Në kuvendet e komunave janë miratuar akte të ndryshme në kuadër të fushëveprimit të kompetencave komunale. Komunitat kanë miratuar Rregulloret për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2013, pastaj Rregulloret për taksa, tarifa dhe ngarkesa, Rregulloret për punën e Kuvendeve të Komunave, Rregullore për barazi gjinore (Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Viti, Klllokot), Rregullore për subvencione, Rregullore për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë negative, Rregullore për shërbimet publike dhe transportin publik etj.

Komunitat si: Mitrovica, Klllokoti, Deçani dhe Kamenica kanë nxjerrë Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, edhe pse nxjerrja e kësaj rregullore nuk kërkohet me Ligjin nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Rregullimi më i hollësishëm i procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim është parë si e nevojshme nga komunitat, sepse ka pasur paqartësi të veprimit për disa çështje, të cilat ligji nuk i ka saktësuar, siç janë: çështja e dhënies së pronës në shfrytëzim për banim social, zgjidhja e banimit për personat e riatdhesuar dhe çështja e shqyrtimit të ankesave të palëve.

Lidhur me menaxhimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e saj, komunitat kanë nxjerrë 44 vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ndërsa janë realizuar 13 raste të këmbimit të pronës komunale me personat fizik dhe juridik. Kuvendet e komunave, paraprakisht kanë themeluar komisionet përgjegjëse për të zhvilluar procedurat si dhe përzgjedhur ofertuesit më të përshtatshëm. Praktika e themelimit të këtyre komisioneve nuk ka qenë e njëjtë nëpër komuna, pasi që disa prej komunave kanë themeluar komisione të veçanta për secilin rast, ndërsa disa të tjera kanë themeluar komisione afatgjata për zhvillimin e këtyre procedurave. Megjithatë, më tepër është praktikuar mundësia e themelimit të komisioneve për raste të veçanta.

Sa u përket akteve të cilat gjenerojnë të hyra materiale, është e nevojshme të theksohet nxjerrja e Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa. Si rregull, plotësim-ndryshimet e kësaj rregulloreje bëhen para miratimit të buxhetit për të realizuar planifikimet buxhetore për vitin pasues. Gjatë kësaj periudhe, sipas kërkesës së Komisionit sektorial, pjesa më e madhe e komunave e kanë bërë rishqyrtimin e kësaj rregullore, me qëllim të harmonizimit të dispozitave të caktuara me ligjet në fuqi.


Me përjashtim të Komunës së Deçanit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit, komunat tjera e kanë realizuar rishikimin e buxhetit për vitin 2013, si dhe kanë miratuar Kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2014-2016.

Gjithashtu, me Rregullore të veçantë komunat kanë përcaktuar kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve për kategoritë e ndryshme të personave fizik dhe juridik. Komunat të cilat kanë miratuar Rregulloren për Ndarje të Subvencioneve janë: Suhareka, Gjilani Rahoveci, Vushtrria, Ferizajt dhe Fushë-Kosova.

1.3. Pjesëmarrja dhe raportimi i kryetarit të komunës

Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e kryetarit të komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në bazë të paragrafit j) të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i komunës është i obliguar të raportoj para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Komunës.

Numri i raportimeve të kryetarëve të Komunave para kuvendit sipas normës së lartpërmendur është si në vijim:



Histogrami nr.8. Raportimi i kryetarëve para kuvendeve të komunave

Siç vërejmë nga histogrami i mësipërm, 6 kryetarë të komunave kanë respektuar madje tejkaluar minimumin e paraparë të raportimit para kuvendeve të komunave, 13 kryetarë kanë raportuar në përputhje me minimumin e paraparë të raportimit. Krahas tyre, 14 kryetarë kanë raportuar vetëm nga një herë duke dështuar të përmbushin minimumin e paraparë me ligj për raportim para kuvendit të komunave, siç është rasti në komunat: Deçan, Gjilan, Glllogoc, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Skenderaj, Suharekë dhe Vushtri. Për dallim nga këto komuna, kryetari i Komunës së Ferizajt nuk ka raportuar asnjëherë para kuvendit të komunës.

Forma të tjera të raportimit kanë qenë edhe ato verbale, ku anëtarësia e kuvendeve ka parashtruar pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj kuvendit të komunës. Kësaj forme të debatimit dhe përpjekjeve për ushtrimin e kontrollit ndaj ekzekutivit i kanë dhënë prioritet komunat: Rahovec, Gjakovë, Deçan, Mitrovicë, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Ferizaj, Kaçanik dhe Vushtri.

Megjithatë, janë të nevojshme përpjekjet e kuvendeve të komunave për të siguruar prezencën e kryetarëve të komunave në mbledhjet e kuvendeve. Kjo për arsye se jo gjithë kryetarët e komunave i kanë kushtuar rëndësi pjesëmarrjes së tyre në mbledhjet e

kuvendeve të komunave. Praktika jo të mira janë pasqyruar në komunat: Malishevë dhe Skenderaj. Krahas tyre, në Komunat: Deçan, Rahovec, Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj dhe Mamushë, kryetarët e komunave jo çdoherë kanë qenë prezent në mbledhjet e Kuvendit.

Në të gjitha komunat janë paraqitur raportet financiare periodike nga kryetarët e komunave. Edhe pse Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë nuk e ka kërkuar votimin (miratimin) e raporteve financiare nga Kuvendet e Komunave, miratimi i tyre është praktikë e shumicës së komunave. Ndërkaq, komunat të cilat nuk praktikojnë votimin e raporteve financiare të ekzekutivit janë: Kaçaniku, Parteshi, Deçani, Graçanica, Gjakova, Mitrovica, Rahoveci dhe Suhareka.

1.4. Takimet publike me qytetarë

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër me të cilën transparenca do të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale çdo komunë mbanë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të viti. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

Në praktikë, organizimi i takimeve publike me qytetarë dallon nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë, e disa të tjera kanë qenë të rezervuara në këtë drejtim. Sipas të dhënave, “në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, 4 komuna kanë dështuar të përmbushin obligimin për mbajtjen e 1 takimi me qytetarë, siç është rasti me: Istogun, Fush-Kosovën, Graçanicën dhe Obiliqin”². Ndërsa duke i'u referuar të dhënave të përgjithshme për tërë vitin 2013, numri i takimeve të organizuara me qytetarë është si në vijim:



Histogrami nr.9. Numri i takimeve publike me qytetarë

² DLMK, MAPL: “Raport i funksionimit të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës, janar-qershor 2013”, Korrik, Prishtinë, 2013, fq. 20.

Histogrami i mësipërm ofron të dhënat se në 34 komuna janë mbajtur 51 takime me qytetarë. Prej tyre, 15 komuna kanë organizuar nga 1 takim publik me qytetarë, 18 të tjera nga 2 takime, përderisa Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka organizuar asnjë takim të tillë. Pra, pasqyra e të dhënave tregon se në përmbushjen e normës ligjore prej së paku 2 takimeve në vit kanë dështuar gjithsej 16 komuna, siç është rasti në: Deçan, Gllogovc, Gjakovë, Gjilan, Istog, Junik, Lipjan, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri dhe Fushë-Kosovë.

Përveç këtyre takimeve, komunat kanë mbajtur edhe takime të tjera me qytetarë (jashtë atyre të obligueshme sipas nenit 68.1 të LVL-së) në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit, janë bërë me rastin e diskutimit të projekt-rregulloreve, planeve dhe çështjeve buxhetore, të cilat qytetarëve u kanë mundësuar ofrimin e vërejtjeve, propozimeve dhe kërkesave të tyre.

Duke marrë parasysh se takimet publike me qytetarë janë të normuara me ligj dhe paraqesin vlera të demokracisë së drejtpërdrejtë, aplikimi i tyre duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe të jetë pjesë integrale e politikave komunale.

1.5. Ueb-faqet zyrtare të komunave

Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të internetit të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2011 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike. Çështjet e tjera të përdorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave që lidhen me transparencën komunale, publikimin e akteve komunale dhe informimin e publikut janë të rregulluara me norma të veçanta të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr.2008/3 për ndryshimin e U.A. Nr.2006/03 për "Transparencën në Komuna" dhe Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave.


Referuar këtyre rregullave, komunat janë përgjegjëse që në mes tjerash të respektojnë parimin e transparencës, të krijojnë lehtësira për qasje të publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunave, si dhe të krijojnë mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare të komunës. Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike të komunave. Marrë parasysh se komunat kanë aktivitete të ndryshme përbrenda institucioneve të tyre, është paraparë si e domosdoshme që futja e të dhënave në ueb faqet komunale të jetë e vazhdueshme, ngase qytetarëve i'u mundëson të jenë më të informuar lidhur me rrethanat dhe ecjet e komunës.

Lidhur me mirëmbajtjen e ueb-faqeve komunale dhe përditësimin e informacioneve në to, në përgjithësi ka një përparim në këtë drejtim. Aktualisht, ueb-faqet zyrtare të komunave janë të programuara në gjuhët zyrtare, kështu që përmbytjet duhet të lansohen në harmoni me rregullat e ligjit për përdorimin e gjuhëve. Kësisoj, ueb-faqet më tepër kanë qenë të azhurnuara me informacione që mbulonin aktivitetet e kryetarëve të komunave dhe performancën komunale. Ajo çfarë mbetet për t'u përmbyshur është azhurnimi i tyre me aktet juridike të miratuara nga organet komunale. Përfshirja e këtyre të dhënave në ueb-faqet komunale është e domosdoshme sepse sipas Rregulloreve Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave publikimi i të gjitha akteve nënligjore të komunës është i obligueshëm. Publikimi i akteve është përcaktuar edhe me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/3 për ndryshimin e U.A. Nr.2006/03 për "Transparencën në

* Në 10 komuna janë azhurnuar rregullisht ueb-faqet zyrtare me publikimin e akteve të kuvendeve, 14 prej tyre vetëm pjesërisht ndërsa 10 nuk i kanë publikuar fare. Komunat të cilat publikimin e akteve të kuvendit e kanë bërë me rregull janë: Gjilani, Kaçaniku, Graçanica, Klokoti, Shtimes, Lipjani, Mitrovica, Kamenica, Hani i Elezit, Prishtinë Ferizaj, Gllogoc. Komunat të cilat këtë e kanë bërë pjesërisht janë: Suhareka, Vushtrria, Peja, Klinë, Istogu, Malisheva, Obiliqi, Lipjani, NovoBërda, Vitia, Dragashi, Podujeva, Fushë Kosovë. Krahas tyre, komunat të cilat nuk i kanë publikuar asnjë nga aktet e miratuara në Kuvendet e Komunave janë: Parteshi, Ranillugu, Skenderaj, Gjakova, Novobërda, Rahoveci, Mamusha dhe Juniku.

Komuna". Përpos kësaj, publikimi i akteve korrespondon me hyrjen në fuqi të tyre. Sipas nenit 18.1 të Rregullores Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave, "aktet nënligjore të komunës hyjnë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës". Mirëpo, edhe pse e përcaktuar me këtë rregullore, postimi i akteve komunale ka qenë jo koherent në komuna. Pjesa më e madhe e komunave nuk i kanë azhurnuar me rregull ueb-faqet komunale me dokumentet zyrtare siç janë: rregulloret, vendimet, planet, procesverbalet dhe raportet e ndryshme.


Nga ky këndvështrim, prej gjithsej 1258 akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave, në faqet zyrtare elektronike të komunave janë publikuar 732 akte, ose në përqindje 58.18%. Për më saktë, prej 149 rregulloret e miratuara janë publikuar 89 sosh, ose 59% e tyre, ndërsa prej 1109 vendimeve janë publikuar 650, ose 58.6%.



Histogrami nr.10. Numri i akteve të publikuara të kuvendeve të komunave

Bazuar në normën e lartpërmendur, 526 akte të cilat nuk janë publikuar, nuk përmbushin kriteret për zbatim për shkak të kushtëzimit të plotfuqishmërisë të tyre me publikimin në ueb-faqet zyrtare.

Për më saktë, përqindja e publikimit të akteve në ueb-faqet e komunave është si në vijim:



Histogrami nr.11. Përqindja e publikimit të akteve të kuvendeve të komunave

Nga figura e mësipërme, vërejmë se komunat të cilat kanë performuar më së miri në publikimin e akteve juridike të kuvendeve të tyre janë: Prishtina, Prizreni, Mitrovica Jugore, Kaçaniku, Gjakova, Malisheva, Ferizaj dhe Shtimja. Krahës tyre, më së dobëti kanë performuar komunat: Junik, Klllokot, Mamushë, Podujevë, Lipjan, Kamenicë të cilat nuk kanë publikuar asnjë akt të miratuar.

Sa i përket publikimit të akteve të kryetarit të komunës, vetëm 3 komuna kanë bërë publikimin e këtyre akteve. Për më saktë, në Komunën e Prizrenit janë publikuar 11 vendime të kryetarit të komunës, 10 në Komunën e Kaçanikut, 1 në Gjilan dhe 1 në Klinë. Në lidhje me këtë,

vetëm 3 komuna e kanë të rregulluar linkun për publikimin e akteve të kryetarit të Komunës (Gjilani, Prizreni dhe Kaçaniku). Në tërësi janë publikuar 23 akte të kryetarit të komunës, që do të thotë se komunat kanë qenë shumë pak transparente në lidhje me këto akte.

Përkritazi me publikimin e akteve të kuvendit të komunës dhe kryetarit të komunës në gjuhët zyrtare, në gjuhën shqipe janë publikuar gjithsej 733 akte, në serbisht 265 akte, kurse në gjuhën turke 44 (në Komunën e Prizrenit)³.

Përveç kësaj, komunat duhet të unifikojnë sistemimin e të dhënave për të lehtësuar qasjen në to. Në të shumën e rasteve ato janë publikuar nëpër linqe të ndryshme, vështirë për t'u identifikuar. Kështu, sistemimi i akteve të publikuara nuk është bërë në bazë të llojit, por në formë të përzier e cila ka përfshirë akte të ndryshme dhe të pa seleksionuara. Në këtë segment, 11 komuna sistemimin e akteve të publikuara e kanë të rregulluar në linkun e shpalljeve, 22 komuna e kanë në linkun Komuna/Kuvendi dhe 1 komunë në Dokumente. Njëkohësisht duhet përmendur se edhe mënyra e publikimit të akteve përbernda linqeve të njëjta është e ndryshme. Andaj, duke u bazuar në këto të dhëna, aktet e publikuara duhet të sistemohen në bazë të organit që i ka nxjerrë, llojit të tyre, vitit dhe datës së miratimit.

Për dallim nga komunat e tjera, gjatë vitit 2013, Komuna e Graçanicës ka përdorur një ueb-faqe jashtë rrjetit qeveritar e cila ka pasivizuar funksionimin e ueb-faqes zyrtare duke mos kryer obligimet ligjore për publikimin e informacioneve dhe akteve komunale, si dhe duke shkelur Udhëzimin Administrativ Nr.03/2011 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike. MAPL, ka monitoruar në vazhdimësi ueb-faqen e kësaj komune dhe si çështje e ka trajtuar në takimet e drejtpërdrejta me zyrtarët komunal. Gjatë monitorimit të drejtpërdrejtë është kërkuar që të vihet në funksion ueb-faqja zyrtare dhe komuna të filloj emetimin e informacioneve dhe akteve komunale. Tani është arritur që ueb-faqja zyrtare e Komunës së Graçanicës të jetë funksionale, kurse ekzistimi i ueb-faqes jashtë serverit qeveritar nuk është më prezent. Përdorimi i UEB-faqes tjetër nga Komuna e Graçanicës jashtë rrjetit qeveritar të Republikës së Kosovës ka qenë në kundërshtim rregullat juridike⁴. Çdo shfrytëzim i programeve softuerike, pajisjeve harduerike dhe administrimi i informatave nga zyrtarët komunal e në veçanti nga zyrtarët e IT-së në nivelin lokal duhet të jetë në përputhje me rregullat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2010 për Përdorimin e Softuerit dhe Harduerit.

1.6. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Udhëzimi Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, ka definuar më qartë pozicionin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Ndryshimet normative me këtë udhëzim, kanë lidhur më ngushtë KKSBB-në me Kuvendin e Komunës. Po ashtu, është rikonfirmuar roli i këtij Këshilli ndaj dukurive negative në shoqëri, si formë mjaft e përshtatshme për zbatimin e politikave të përgjithshme preventive sociale. Janë përcaktuar një numër i objektivave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit të pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit. Për më tepër, është përcaktuar e drejtën e Kuvendit të Komunës për themelimin e KKSBB-së dhe përgjegjësia e kryetarit të komunës për të bërë më funksionale


³ Për më tepër: Shtojca 2: Tabela e publikimit të akteve të komunave në faqet zyrtare elektronike

⁴ Përdorimi i Ueb-faqeve zyrtare nga institucionet publike, është rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2011 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike. Sipas nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktuar që "Ueb-faqja e institucionit publik duhet të ketë në adresë, inicialet e emërimit zyrtar të institucionit dhe emërtimin e domenit të institucionit përkatës", kurse në bazë të nenit 5 të këtij udhëzimi administrativ "të gjitha institucionet publike obligohen që hostimin e ueb faqeve të bëjnë në serverët e Qendrës së të Dhënave të Republikës së Kosovës". Nga kjo kuptohet se komunat janë të obliguara të kenë vetëm një ueb-faqe zyrtare përbrenda rrjetit qeveritar.

këtë organ, përfshirë informimin e Kuvendit për aktivitetet e zhvilluara. Ndër të tjera është ndryshuar numri minimal i takimeve nga dhjetë në gjashtë takime në vit, tri prej të cilave është paraparë të mbahen në gjashtëmuajorin e parë⁵.

Sipas rregullave të reja, themelimi i KKSB-ve është bërë në të gjitha komunat, me përjashtim të Komunës së Kaçanikut e cila nuk ka nxjerrë vendimin për themelimin e KKSB-ve sipas referencave të Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Mirëpo, përkundër normimit të këtyre kriterëve për funksionalizimin e KKSB-ve, në institucionet e nivelit lokal të qeverisjes ende mungon vetëdija e përgjithshme për rëndësinë e këtij mekanizmi. Në përgjithësi, intensiteti i punës së KKSB-ve vlerësohet në rënie. Për këtë, më së miri flasin të dhënat e mëposhtme të takimeve të KKSB-së:



Histogrami nr. 12. Numri i takimeve të KKSB-së

Nga histogrami i mësipërm, shihet se vetëm në Komunën e Hanit të Elezit është përmbushur kriteri i mjaftueshëm i takimeve të KKSB-së. Krahës saj, asnjë komunë tjetër nuk ka mbajtur numrin e nevojshëm të mbledhjeve sipas udhëzimit administrativ.

Kuvendet e komunave dhe kryetarët e tyre, duhet të fokusohen më tepër rreth prioriteteve të sigurisë, e posaçërisht për funksionalizimin e KKSB-së, si organ kryesor për përfaqësimin e nevojave të sigurisë së qytetarëve. Gjithashtu, komunat duhet shtuar numrin e takimeve të këtij Këshilli së paku deri në pragun minimal të përcaktuar me Udhëzim Administrativ.

⁵ Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 11.2.

1.7. ZGJEDHJET LOKALE DHE KONSTITUIMI I ORGANEVE TË KOMUNAVE

Mbajtja e zgjedhjeve lokale në Kosovë është e rregulluar në bazë të normave, parimeve, dhe kriterëve të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë mbahen çdo 4 vite.

1.7.1. Shpallja dhe mbajtja e zgjedhjeve lokale


Bazuar në nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe në konsultim me partitë politike dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Presidentja e Kosovës znj. Atifete Jahjaga, me datën 03.11.2013 ka nxjerrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve lokale në gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës. Sipas vendimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës të Kosovës (KQZ-ja) është urdhëruar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale, në përputhje me këtë vendim dhe ligjet në fuqi.

Zgjedhjet lokale për kryetar të komunave dhe kuvende të komunave janë mbajtur në 38 komuna. E veçantë e këtij procesi, ka qenë mbajtja e zgjedhjeve në 4 (katër) Komunitetet e pjesës veriore të Kosovës dhe konstituimi i organeve lokale në këto komuna.

Ky proces është monitoruar nga Misioni për Monitorimin e Zgjedhjeve (MBEVZ) i cili është udhëhequr nga Shefi i Misionit, Roberto Gualtieri, deputet në Parlamentin Evropian.

1.7.2. Zgjedhja e kryetarëve të komunave dhe certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve

Në raundin e parë të zgjedhjeve të mbajtura me datë 03.11.2013 janë zgjedhur nëntë kryetarë të komunave, si në: Skenderaj, Deçan, Fushë-Kosovë, Shtime, Kaçanik, Hani të Elezit, Istog, Shtërpçë, Mamushë dhe Podujevë. Ndërsa në 28 komuna, kryetarët janë zgjedhur në raundin e dytë të mbajtur më 01.12.2013. Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve nga Komisionin Qendror Zgjedhor për zgjedhjet lokale të mbajtura në të dy raundet në Republikën Kosovës, është bërë me datën 11.12.2013.



Histogrami nr. 13. Zgjedhja e kryetarëve të komunave sipas raundeve zgjedhore

Pas certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, Ministria e Administrimit të Pushteti Lokale ka ndërmarr të gjitha veprimet e saj në pajtueshmëri me obligimet që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Për dallim nga komunat e tjera, në Komunën e Mitrovicës së Veriut janë përsëritur zgjedhjet për kryetar të komunës, për shkak të mosdhënies së betimit të kandidatit me numrin më të madh të votave. Lidhur me këtë, Presidentja e Republikës së Kosovës ka vendosur të shpallë datën 23 shkurt si ditën kur do të mbahen zgjedhjet për kryetar komune në Mitrovicën e Veriut, si dhe ka udhëzuar Komisionin Qendror Zgjedhor për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të kësaj komune. Këto zgjedhje janë mbajtur në datën e shpallur nga Presidentja, ndërsa rezultatet janë komunikuar me datën 26 shkurt 2014 nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Republikës së Kosovës.

1.7.3. Konstituimi i kuvendeve të komunave pas zgjedhjeve lokale

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave, përmes Divizionit të Monitorimit të Komunave, ka monitoruar mbajtjen e seancave inauguruese të Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës. Pikësynim i këtij procesi ka qenë monitorimi i procedurave ligjore, duke filluar nga dërgimi i ftesave për thirrje të seancave inauguruese, e deri në dhënien e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarët e Komunave. Monitorimi i këtyre seancave është bërë përmes dy mekanizmave ligjor, prezencës fizike të zyrtarëve të MAPL-së dhe sistemit të “Teleprezencës”.

Seancat inauguruese janë mbajtur në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës. Seanca e parë inauguruese është mbajtur nga Komuna e Suharekës me datën 18.12.2013, ndërsa seancat e fundit janë mbajtur me datën 11.01.2014 në 4 Komunat veriore të Republikës së Kosovës: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Disa nga komunat përveç dhënies së betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe betimit të Kryetarit të Komunës, kanë futur në rend dite edhe zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit. Komunat të cilat kanë zgjedhur Kryesuesin e Kuvendit të Komunën në seancat inauguruese janë: Komuna e Vushtrrisë, Komuna e Ferizajt, Komuna e Kaçanikut, Komuna e Skenderajt, Komuna e Lipjanit, Komuna e Dragashit, Komuna e Fushë-Kosovës, Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Junikut, dhe Komuna e Shtërpçës.

Përgjithësisht, procesi i mbajtjes së mbledhjeve inauguruese ka qenë i rregullt, me përjashtim të disa vështirësive të shfaqura në Kuvendin e Komunës së Parteshit. Megjithatë, e rëndësishme është se të gjitha Kuvendet e Komunave janë themeluar dhe funksionalizuar, betimi i anëtarëve të kuvendeve të komunave dhe kryetarëve është bërë sipas afatit ligjor, janë themeluar mekanizmat e nevojshëm për funksionimin e kuvendeve të komunave, janë emëruar drejtorët e drejtorive komunale duke funksionalizuar ekzekutivin, është ruajtur kontinuiteti i funksionimit të administratës së komunave, si dhe janë ndërmarrë hapa për eliminimin e pozitave të dyfishta dhe konfliktit të interesit.

1.8. MBIKËQYRJA E KOMUNAVE

Mekanizmi kryesor për ushtrimin e mbikëqyrjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është e drejta e autoritetit mbikëqyrës për shqyrtimin administrativ të ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të komunave. Parimisht, MAPL është autoriteti mbikëqyrës i komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato⁶. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale, janë themeluar komisionet ndërmministrore, sipas fushave specifike. Në vijim janë paraqitur rastet e shkeljeve ligjore të vitit 2013, shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre nga MAPL, shqyrtimi i ligjshmërisë nga Komisionet ndërmministrore, kërkesat për rishqyrtim të akteve dhe veprimet e komunave pas pranimit të shkresave për rishqyrtim.

1.8.1. Dërgimi i akteve për shqyrtim të ligjshmërisë

Sipas nenit 80 të LVL-së, komunat kanë përgjegjësi të dërgojnë aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Derisa në një periudhë komunat kanë paraqitur pengesa për dërgimin e akteve dhe nuk kanë treguar bashkëpunim të mirë me nivelin qendror, tani shumica e komunave e kanë rregulluar këtë segment.


Gjatë periudhës janar-dhjetor 2013, të gjitha komunat kanë sjellë aktet e kuvendeve për vlerësim të ligjshmërisë, por disa nuk kanë respektuar afatet ligjore për këtë qëllim. Komunat të cilat janë vonuar në dërgimin e akteve me kohë për shqyrtim të ligjshmërisë janë: Rahoveci, Juniku, Deçani, Peja, Gillogoci, Mamusha dhe Prizreni. Problemet e vonësive kanë qenë të ndryshme, disa për shkak të dërgimit të akteve në formë fizike, të tjerat për shkak të vonësive së hartimit të akteve, për shkak të përkthimit në gjuhët zyrtare, ose pengesave të caktuara brenda komunës. Në pikëpamje të veprimit të përgjithshëm, komunat kanë ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për dërgimin e akteve, të bazuar kryesisht në dërgesën elektronike, e cila i plotëson të gjitha kriteret e domosdoshme për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit të ligjshmërisë.

1.8.2. Shkeljet ligjore të evidentuara

MAPL, përmes monitorimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave ka evidencuar të gjitha aktet e nxjerra në Kuvendet e Komunave. Aktet të cilat nuk kanë qenë në kompetencë të autoriteteve të tjera të nivelit qendror, MAPL i ka vlerësuar nga këndvështrimi ligjor. Në anën tjetër, aktet për të cilat është vlerësuar jokompetenca, janë dërguar në ministrinë përgjegjëse, përkatësisht në komisionet ndërmministrore. Nga i gjithë ky proces, janë evidentuar një numër i shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve nga kuvendet e komunave.

Në vijim, është paraqitur figura me të dhënat për procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale:

⁶ RKS, Kuvendi, LVL, Kreu X, Nenet 75 dhe 76



Histogrami nr.14. *Procesi i shqyrtimit administrativ*

Nga figura e mësipërme, shihet se autoriteti mbikëqyrës ka vlerësuar 59 akte të kundërligjshme. Komunat kanë rishqyrtuar 39 akte ose 66%, prej të cilave 27 janë harmonizuar me vërejtjet e organit mbikëqyrës ose 69%, ndërsa 12 vendime edhe pas rishqyrtimit nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesat e organit mbikëqyrës ose 30%. Krahës tyre, 20 akte nuk janë rishqyrtuar fare ose 33%.

1.8.3. Kërkesat e organit mbikëqyrës për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme të kuvendeve të komunave

Për të gjitha rastet e shkeljeve ligjore, autoriteti mbikëqyrës është drejtuar me shkresë për rishqyrtim dhe harmonizim me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të këtyre shifrave, janë përfshirë edhe rastet të cilat kanë qenë pjesë e procedurës së shqyrtimit dhe rishqyrtimit për dy ose më tepër herë, e sidomos Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa.

1.8.4. Harmonizimi i akteve sipas rekomandimit të MAPL-së

Janë 11 raste të konstatimit të kundërligjshmërisë, për të cilat komunat kanë vepruar konform rekomandimit për rishqyrtim. Komunat të cilat kanë vepruar në këtë mënyrë janë: Rahoveci (2 vendime), Prizreni (2), Kamenica (1), Ferizaj (2), Viti (1), Skenderaj (1), Novobërda (1) dhe Mitrovica (1).

Shtatë prej vendimeve të harmonizuara kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale. Këto vendime janë harmonizuar në komunat: Rahovec (2 vendime), Prizren (2), Ferizaj (2), Viti (1) dhe Novobërdë (1). Po ashtu, 1 vendim i harmonizuar ka të bëjë më këmbimin e pronës në Komunën e Skenderajt.

Sa u përket rekomandimeve të tjera, ato janë marrë për bazë nga Komuna e Kamenicës me rastin e themelimit të KKS-së, si dhe me rastin e rishqyrtimit të Vendimit për ndërrim të destinimit të lokacionit për ndërtimin e Qendrës së Shëndetit Mendor në Komunën e Mitrovicës.

1.8.5. Harmonizimi i akteve sipas rekomandimit të komisioneve sektoriale

Prej akteve të kërkuara për rishqyrtim nga Komisionet sektoriale, komunat kanë ndërmarrë veprime në 16 shkelje të konstatuara, si në vijim:

- Sipas rekomandimeve të komisionit ndërmintor, janë rishqyrtuar dhe harmonizuar Rregulloret për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale të dhjetë kuvendeve të komunave: Malishevë, Shtime, Vushtrri, Rahovec, Istog, Klllokot, Prishtinë, Gjilan, Novobërdë dhe Fushë-Kosovë;
- Sipas rekomandimeve të komisionit ndërmintor është rishqyrtuar dhe harmonizuar Rregullorja për të hyrat vetanake në Komunën e Ferizajt;
- Komuna e Prishtinës ka bërë harmonizimin e 2 planeve rregulluese urbane sipas rekomandimeve të organit mbikëqyrës;
- Komuna e Prishtinës ka harmonizuar nivelin e tarifave komunale për lëshimin e vërtetimeve konform shkresës së ministrisë;
- Komuna e Mitrovicës ka harmonizuar Vendimin për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të rrugëve të pa kategorizuar dhe rikonstruktiv të rrugëve;
- Komuna e Kaçanikut ka harmonizuar Rregulloren për ndarjen e bursave për studentë konform rekomandimeve të organit mbikëqyrës;


1.8.6. Aktet e kundërligjshme të rishqyrtuara nga kuvendet e komunave dhe të paharmonizuara me rekomandimet e organit mbikëqyrës

Dymbëdhjetë akte të kundërligjshme të komunave, edhe pse janë rishqyrtuar në kuvendet e tyre, nuk janë harmonizuar me vërejtjet e organit mbikëqyrës. Në këtë grup të shkeljeve bëjnë pjesë:

- Rregullorja për tarifa, ngarkesa, gjoba dhe ngarkesa komunale në Komunit: Pejë Dragash dhe Viti;
- Vendimi për miratimin e Planit Zhvillimor Urban për periudhën 2013-2022 nga Komuna e Prishtinës;
- Vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban për lagjen "Grap" në Studenqan të Komunës së Suharekës;
- Vendimi për dhënien e pëlqimit për realizimin e projektit ndërtimi i hidrocentralit në Gryken e Erenikut nga Komuna e Junikut;
- Vendimi për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Prizrenit;
- 3 vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme nga Komuna e Prizrenit
Vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urbanistik për legalizimin e objektit banesor ZK, Graçanicë;
- Vendimi për miratimin e Rregullores për Mbrojtje nga Zjarri nga Komuna e Shtërpçës.

1.8.7. Shkeljet ligjore të konstatuara nga MAPL, të cilat nuk janë rishqyrtuar në kuvendet e komunave edhe pas shkresës për rishqyrtim

Janë gjithsej 20 akte të cilat nuk janë rishqyrtuar nga komunat edhe pas konstatimit të kundërligjshmërisë nga organi mbikëqyrës. Në vijim është paraqitur histogrami për numrin dhe llojet e akteve që nuk janë rishqyrtuar:



Histogrami nr.15. Aktet që nuk janë rishqyrtuar nga kuvendet e komunave

Rastet e kundërligjshme për të cilat nuk janë ndërmarrë veprime nga komunat për t'i rishqyrtuar:

- **2** vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit;
- **3** vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale nga Kuvendi i Komunës së Pejës;
- **1** vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës;
- **1** vendime për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit;
- **3** vendime për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nga Kuvendi i Komunës së Pejës;
- **1** vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës;
- **1** vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë;
- **1** vendim lidhur me formimin e Komisionit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim në Komunën e Rahovecit.
- **1** Vendim lidhur me fshatin Hoqë e Madhe, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.
- **1** Vendim për ndërrimin e destinimit të pronës në Komunën e Klllokotit;
- **1** Vendim për themelimin e ndërmarrjes publike komunale në Komunën e Vitisë;
- **1** Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Graçanicës.
- **1** Rregullore për kompensimin e pagave të ish-zyrtarëve të lartë të komunës e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit;
- **1** Vendim për ndarjen e truallit për xhami në Komunën e Shtimes.

II. PERFORMANCA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Kjo pjesë e seksionit jep rezultatet e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët. Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale (SMPSHK) është përqendruar në rezultate për të paraqitur të arriturat e komunës. Raporti monitoron ngritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve komunale nga viti në vit, duke e krahasuar bazën e të dhënave të cilën tashmë e kanë komunat dhe MAPL.

Raporti prezanton të dhënat e komunave sipas fushave specifike, duke përfshirë të gjithë treguesit matës të shërbimeve të ofruara nga komunat gjatë vitit 2013. Ky raport vë në pah ndryshimet cilësore të arritura nga komunat për vitin 2013 në ofrimin e shërbimeve publike. Në këtë raport janë nxjerrë mesataret për ofrimin e shërbimeve në nivel të vendit dhe janë radhitur komunat të cilat kanë ofruar shërbimet e tyre mbi nivelin mesatar të vendit, për disa shërbime specifike.


2.1. Shërbimet Administrative

Në tabelën 1 janë prezantuar Shërbimet Administrative të cilat janë ofruar për qytetarët. Mesatarja e ofrimit të këtyre shërbimeve në nivel të komunave të Kosovës është 85.29%. Komunat të cilat i kanë ofruar shërbimet administrative mbi nivelin mesatar janë: Graçanicë (99.58%), Hani i Elezit (99.48%), Skenderaj (99.22%), Malishevë (97.96%), Klllokot (97.92%), Ranillug (97.72%), Vushtrri (97.70%), Gjilan (97.55%), Ferizaj (97.34%), Viti (95.99%), Partesh (95.23%), Mitrovicë (94.70%), Mamushë (94.40%), etj. Gjithsejtë numri i komunave të cilat kanë ofruar shërbimet e tyre administrative mbi nivelin mesatar është 19. Numri i komunave të cilat i kanë ofruar shërbimet e tyre nën nivelin mesatar janë 16 dhe numri i komunave të cilat nuk i kanë raportuar të dhënat e tyre është 3. Këtu duhet thënë se disa nga komunat në të dhënat e ofruara nuk i kanë përfshi lëndët nga gjendja civile.

Tabela 1: Shërbimet Administrative

Komuna	Numri i gjithëmbarsëm i lëndëve	Numri i lëndëve të shqyrtuara brenda vitit	% e Lëndëve të Shqyrtuara brenda vitit
Mesatarja	1.023.283	872.780	85.29
Deçan	14.173	5.621	53.31
Gjakovë	5.678	4.872	85.80
Glllogoc	27.585	24.377	88.37
Gjilan	131.949	128.718	97.55
Dragash	4.923	1.729	35.12
Istog	4.654	3.596	77.26
Kaçanik	32.684	22.660	69.33
Klinë	4.989	3.952	79.21
Fushë Kosovë	20.936	16.686	79.70
Kamenicë	27.590	9.659	35.00
Mitrovicë	31.925	30.233	94.70
Leposaviq	-	-	-
Lipjan	23.960	18.246	76.15
Novobërdë	1.800	604	35.55
Obiliq	12.210	9.851	80.67
Rahovec	33.312	27.347	82.09
Pejë	8.191	4.522	55.20
Podujevë	32.819	30.182	91.96
Prishtinë	250.986	223.119	88.89
Prizren	61.641	25.679	41.65
Skenderaj	33.697	33.437	99.22
Shtime	18.695	15.807	84.55
Shtërpçë	5.196	4.204	80.90
Suharekë	9.726	3.809	39.16
Ferizaj	87.741	85.412	97.34
Viti	37.968	36.448	95.99
Vushtrri	35.003	34.199	97.70
Zubin potok	-	-	-

ZAMV	4.578	3.917	85.56
Malishevë	27.618	27.055	97.96
Hani i Elezit	7.948	7.907	99.48
Mamushë	679	641	94.40
Junik	8.732	7.612	87.17
Klllokot	338	331	97.92
Gračanicë	15.627	15.562	99.58
Ranillug	1.361	1.330	97.72
Partesh	3.629	3.456	95.23
Zveçan	-	-	-



Histogrami Nr.16. Shërbimet Administrative


2.2. Mirëqenia Sociale dhe Familjare

Në tabelën 2 janë prezantuar disa tregues matës (indiktorë) nga fusha e mirëqenies sociale. Te numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuar të cilët janë të punësuar në institucionet e komunës, prijnë komunat: Podujeva me 27 të punësuar, Skenderaj me 25, Istogu me 14, Deçani me 9, Fushë-Kosova 7, etj. Në treguesit matës të mirëqenies sociale dhe familjes, ndër të tjera paraqitet cilësia e shërbimeve sociale përmes numrit të rasteve të përfshira në skemën e asistencës sociale dhe numrit të ankesave për asistencë sociale. Të dhënat vënë në dukje se komunat kanë përfshirë në skemën sociale gjithsej 33,354 raste ndërsa numri i ankesave arrin në gjithsej 1563 ankesa.

Tabela 2: Mirëqenia Sociale & Familjare

Komunat	Numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuar që janë të punësuar në institucione komunale	Numri i kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë	Numri i familjeve të vendosura në strehimore kolektive	Numri i rasteve nën përkujdesje sociale	Numri i ankesave për shërbimet sociale
Gjithsej	144	2456	1123	33.354	1563
Deçan	9	15	87	979	20
Gjakovë	4	143	49	1249	0
Gillogoc	0	81	0	1462	121
Gjilan	5	85	53	1136	196
Dragash	8	27	0	307	0
Istog	14	23	18	670	22
Kaçanik	0	22	9	73	4
Klinë	3	52	0	1054	32
Fushë Kosovë	7	114	58	760	24
Kamenicë	2	60	32	618	26
Mitrovicë	5	66	31	2013	343
Leposaviq	-	-	-	-	-
Lipjan	3	98	25	1243	78
Novobërdë	0	0	354	0	15
Obiliq	0	0	0	1118	0
Rahovec	2	1	0	609	30
Pejë	9	236	24	1404	117

Podujevë	27	84	132	3114	134
Prishtinë	1	105	44	4100	30
Prizren	2	284	23	3056	40
Skenderaj	25	250	0	1323	4
Shtime	4	4	4	482	27
Shtërpçë	1	0	25	313	15
Suharekë	2	75	0	719	25
Ferizaj	0	284	13	956	194
Viti	1	53	8	746	28
Vushtrri	1	210	76	1585	6
Zubin potok	-	-	-	-	-
ZAMV	0	0	0	445	1
Malishevë	1	4	10	800	0
Hani i Elezit	0	0	0	312	1
Mamushë	0	0	0	26	0
Junik	8	0	0	128	4
Klllokot	0	0	0	71	5
Gračanicë	0	50	48	184	15
Ranillug	-	-	-	241	6
Partesh	0	0	0	58	0
Zveçan					



Histogrami Nr.17. Shërbimet e Mirëqenies Sociale


2.3. Kulturë, Rini dhe Sport

Në tabelën 3 në treguesit matës për Kulturë, Rini dhe Sport ndër të tjera është paraqitur numri i aktiviteteve komunale për Kulturë, Rini dhe Sport. Ashtu siç shihet në tabelën në vijim komunat të cilat kanë organizuar më shumë aktivitete për Rini, Sport dhe Kulturë janë: Ferizaj me 4714, Suharekë me 1220, Gjakovë me 555, Mitrovicë me 454, Viti me 448, Fushë Kosovë me 405 aktivitete, etj.

Tabela 3: Kulturë, Rini, Sport

Komunat	Gjithsej numri i aktiviteteve komunale në të tri sektorët: a. rini b. sport c. kulturë	Gjithsej numri i objekteve sportive në zonat komunale: a. rurale b. urbane	Gjithsej numri i objekteve për aktivitete rinore në zonat komunale: a. rurale b. urbane	Gjithsej numri i objekteve për aktivitete kulturore në zonat komunale: a. rurale b. urbane
Gjithsejtë	10046	460	150	289
Deçan	100	4	1	2
Gjakovë	555	44	4	16
Glllogoc	48	6	2	2
Gjilan	48	6	14	24
Dragash	85	5	4	8
Istog	113	7	5	10
Kaçanik	40	20	6	6
Klinë	29	6	2	14
Fushë Kosovë	405	21	10	20

Kamenicë	195	11	2	3
Mitrovicë	454	10	1	3
Leposaviq	-	-	-	-
Lipjan	21	20	3	7
Novobërdë	58	2	4	7
Obiliq	31	0	0	0
Rahovec	38	8	2	6
Pejë	223	21	4	10
Podujevë	197	20	9	23
Prishtinë	391	51	4	22
Prizren	173	13	14	17
Skenderaj	27	9	1	3
Shtime	25	25	21	25
Shtërpcë	17	14	0	1
Suharekë	1220	40	2	4
Ferizaj	4714	25	4	9
Viti	448	1	0	0
Vushtrri	127	5	7	13
Zubin potok	-	-	-	-
ZAMV	0	0	0	0
Malishevë	30	14	1	3
Hani i Elezit	1	3	0	1
Mamushë	15	3	0	2
Junik	65	0	1	1
Klllokot	61	0	1	5
Graçanicë	52	23	7	8
Ranillug	22	11	9	9
Partesh	18	12	5	5
Zveçan				




Histogrami Nr.18. Kulturë, Rini dhe Sport

2.4. Emergjencat Lokale

Në tabelën 4 në treguesit matës të shërbimit të Emergjencave Lokale, janë paraqitur numri i rasteve emergjente dhe numri i rasteve emergjente për të cilat ekipet është dashur të dalin në vendin e ngjarjes. Siç shihet në tabelë numri i rasteve emergjente është 9.149, ndërsa ekipet kanë dalë në vend të ngjarjes për 9.501 raste. Për dallim nga vitet e mëparshme vlera e pasurisë së humbur e paraqitur nga komunat është në vlerë prej 3,728,818.00 euro, e cila paraqet një vlerë mjaft të madhe. Derisa koha mesatare e duhur për të arritur në vend të ngjarjes është 11.46 minuta

Tabela 4: Menaxhimi i emergjencave lokale

Komunat	Numri rasteve emergjente - fatkeqësitë (zjarre, vërshime, tërmete)	Vlera e pasurisë së humbur gjatë rasteve emergjente në Euro në vit	Numri i rasteve emergjente, për të cilat ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes	Koha totale vjetore për arritjen në vend të ngjarjes për të gjitha rastet emergjente në minuta	Koha mesatare e nevojshme për të arritur në vendin e ngjarjes në minuta
Gjithsej	9.149	3.728.818,00	9.501	108.855.10	11.46
Deçan	2	25.000.00	62	1240.00	20.00
Gjakovë	848	698.42	640	4.48	7.00
Glllogoc	246	111.152.00	173	2272.00	13.00
Gjilan	530	-	474	3159.00	6.66
Dragash	227	200.000.00	168	4032.00	24.00
Istog	192	235.000.00	160	2880.00	18.00
Kaçanik	113	101.150	106	1358.60	12.68
Klinë	136	75.000.00	136	1086.00	8.00
Fushë Kosovë	180	-	180	43.00	15.00
Kamenicë	245	118.000.00	236	2006.00	8.50
Mitrovicë	456	15.000.00	405	10.90	10.90
Leposaviq	-	-	-	-	-
Lipjan	372	-	331	4625.00	14.00
Novobërdë	63	70.00	63	13.25	0.21
Obiliq	19	59.000.00	19	300.00	15.79
Rahovec	152	97.000.00	152	20.00	0.13
Pejë	396	785.000.00	396	2409.00	6.08
Podujevë	429	11.300.00	429	20.00	0.05
Prishtinë	1643	780.000.00	1643	13144.00	8.00
Prizren	462	-	462	41769.00	90.41
Skenderaj	212	78.546.00	212	11785.00	55.59
Shtime	87	31.99	87	770.82	8.86
Shtërpçë	12	12.000.00	12	120.00	10.00
Suharekë	450	178.600.00	244	1856.00	7.61
Ferizaj	479	-	1653	18348.30	11.10
Viti	33	84.000	59	1002.26	17.00
Vushtrri	754	796.770.00	600	8995.00	15.00
Zubin potok	-	-	-	-	-
ZAMV	-	-	-	-	-
Malishevë	212	50.025.30	212	-	0.15
Hani i Elezit	16	5.600.00	16	240.00	15.00
Mamushë	27	7.500.00	24	210.00	8.75
Junik	14	8.000.00	45	319.00	7.09
Klllokot	0	-	-	-	-
Gračanicë	112	-	81	3142.00	38.79
Ranillug	6	290.00	4	-	-
Partesh	24	3.000.00	10	20.00	2.00
Zveçan	-	-	-	-	-




Histogrami Nr.19. Shërbimet e Emergjencave Lokale

2.5. Planifikimi Urban

Në tabelën 5 në treguesit matës për planifikimin urban është paraqitur përqindja e sipërfaqes së tokës që posedon plane rregulluese (32.28%), përqindja aktvendimeve të ekzekutuara nga inspekcioni i ndërtimit (60.94%). Sa i përket këtij treguesi më së miri qëndrojnë komunat: Fushë Kosovë, Deçan, Obiliq, Podujevë, Shtime, Shtërpçë, Malishevë, Junik, etj. Përderisa afro 93.56% e kërkesave për leje ndërtimi janë shqyrtuar nga ana e komunave.

Tabela 5: Planifikimi Urban (planifikimi, ndërtimi, rregullimi i ndërtimit)

Komunat	Përqindja e sipërfaqes së tokës/zonës urbane për të cilën ekzistojnë planet rregulluese në ha	% e aktvendimeve të ekzekutuara nga inspekcioni i ndërtimit	% e kërkesave të shqyrtuara për leje ndërtimi
Mesatarja	32.28	60.94	93.56
Deçan	8.10	100.00	-
Gjakovë	50.75	-	94.85
Glllogoc	25.10	25.00	97.22
Gjilan	73.23	23.12	95.74
Dragash	14.12	-	100.00
Istog	53.33	-	100.00
Kaçanik	21.22	35.14	94.38
Klinë	100.00	75.00	83.87
Fushë Kosovë	50.62	100.00	100.00
Kamenicë	42.94	40.00	88.89
Mitrovicë	-	33.33	100.00
Leposaviq	-	-	-
Lipjan	9.76	57.69	96.67
Novobërdë	-	0.00	100.00
Obiliq	-	100.00	75.00
Rahovec	-	15.73	97.87
Pejë	81.82	23.24	49.32
Podujevë	26.21	100.00	98.10
Prishtinë	34.80	76.80	93.64
Prizren	70.00	2.86	100.00
Skenderaj	51.06	60.00	100.00
Shtime	-	100.00	100.00
Shtërpçë	-	100.00	86.79
Suharekë	12.08	89.42	100.00
Ferizaj	28.00	31.30	98.87
Viti	49.62	61.54	100.00
Vushtrri	10.64	53.15	100.00
Zubin potok	-	-	-
ZAMV	-	-	100.00
Malishevë	100	100.00	100.00
Hani i Elezit	-	-	80.00
Mamushë	76.60	-	-
Junik	15.12	100.00	-
Klllokot	-	-	83.33
Gračanicë	72.09	10.34	83.55
Ranillug	-	-	100.00
Partesh	-	70.83	95.83
Zveçan	-	-	-




Histogrami Nr.20. Planifikimi Urban

2.6. Parqet dhe sheshet

Në tabelën 6 në treguesit matës për parqet dhe sheshet është paraqitur përqindja e sipërfaqes së parkut/sheshit për kokë banori (1,61 m²) dhe përqindja e parqeve-shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm (73.70%).

Tabela 6: Parqet dhe sheshet

Komunat	Sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror (m ²)	% e parqeve-shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm
Mesatarja	1.61	73.70
Deçan	0.01	100.00
Gjakovë	-	45.00
Glllogoc	0.90	100.00
Gjilan	0.72	19.35
Dragash	0.02	40.00
Istog	0.76	60.00
Kaçanik	3.51	100.00
Klinë	1.16	-
Fushë Kosovë	0.19	100.00
Kamenicë	0.82	-
Mitrovicë	0.89	90.00
Leposaviq	-	-
Lipjan	0.46	100.00
Novobërdë	0.14	100.00
Obiliq	1.65	88.89
Rahovec	0.27	18.92
Pejë	3.83	53.57
Podujevë	1.72	37.50
Prishtinë	5.21	81.82
Prizren	0.11	95.45
Skenderaj	0.19	-
Shtime	7.14	100.00
Shtërpçë	0.32	100.00
Suharekë	1.19	45.45
Ferizaj	2.22	72.97
Viti	0.05	100.00
Vushtrri	0.86	45.45
Zubin potok	-	-
ZAMV	0.00	-
Malishevë	8.27	100.00
Hani i Elezit	1.04	-
Mamushë	2.00	100.00
Junik	0.42	100.00
Klllokot	0.27	-
Gračanicë	3.96	73.08
Ranillug	0.22	50.00
Partesh	4.20	20.00
Zveçan	-	-




Histogrami Nr.21. Parqet dhe Sheshet

2.7. Rrugët

Në tabelën 7 në treguesit matës për rrugët është paraqitur përqindja e rrugëve të përfshira në planin komunal për pastrim/fshirje/larje (29.23%), përqindja e rrugëve lokale në komunë që janë të asfaltuara (73.58%), përqindja në kilometër e rrugëve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve (76.81%). Në treguesit e mirëmbajtjes së rrugëve më së miri qëndrojnë komunat Novobërdë, Partesh dhe Prishtinë.

Tabela 7: Rrugët

Komunat	% e km të rrugëve, të përfshira në planin komunal për pastrim / fshirje / larje	% e rrugëve lokale në komunë, që janë të asfaltuara	% e km rrugë, të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve
Mesatarja	29.23	73.58	76.81
Deçan	3.41	64.77	56.82
Gjakovë	8.39	70.53	70.53
Glllogoc	19.15	80.21	100.00
Gjilan	4.54	65.37	99.57
Dragash	51.41	11.86	51.64
Istog	11.49	70.69	80.46
Kaçanik	1.95	77.30	27.06
Klinë	8.71	94.61	93.36
Fushë Kosovë	28.13	66.25	25.00
Kamenicë	1.31	74.24	83.84
Mitrovicë	53.85	57.69	100.00
Leposaviq	-	-	-
Lipjan	3.06	52.48	52.48
Novobërdë	100.00	61.60	100.00
Obiliq	26.67	78.27	53.33
Rahovec	5.49	52.15	82.34
Pejë	47.36	82.11	82.11
Podujevë	10.81	78.38	100.00
Prishtinë	89.35	96.36	85.55
Prizren	14.44	71.25	57.50
Skenderaj	10.33	67.78	90.99
Shtime	5.38	100.00	100.00
Shtërpçë	56.35	58.33	56.35
Suharekë	3.51	83.16	100.00
Ferizaj	29.29	83.93	96.79
Viti	3.03	89.09	76.71
Vushtri	16.08	92.69	74.27
Zubin potok	-	-	-
ZAMV	-	-	-
Malishevë	6.00	80.00	80.00
Hani i Elezit	60.18	60.18	60
Mamushë	61.54	84.62	61.54
Junik	56.64	56.64	75.78
Klllokot	-	100.00	-
Gračanicë	37.67	84.19	84.19
Ranillug	-	-	-
Partesh	100.00	81.64	100.00
Zvečan	-	-	-




Histogrammi Nr.22. Rrugët Lokale

2.8. Trotuaret

Në tabelën 8 në treguesit matës për trotuaret janë paraqitur përqindja e trotuareve të rregulluara në kilometra (32.82%) dhe përqindja në kilometër e trotuareve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen (pastrim-fshirje) verore/dimërore (66.19%). Tek mirëmbajtja e trotuareve më se mirë qëndrojnë komunat: Fushë Kosovë, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Shtërpçë, Vushtrri, Malishevë, Hani i Elezit, Junik, Graçanicë, Ranillug, Partesh.

Tabela 8: Trotuaret

Komunat	% e km të trotuareve të rregulluara	% e km të trotuareve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen (pastrim-fshirje) verore/dimërore
Mesatarja	32.82	66.19
Deçan	12.28	71.43
Gjakovë	40.56	-
Glllogoc	95.74	95.74
Gjilan	68.84	46.65
Dragash	100.00	0.95
Istog	28.46	40.00
Kaçanik	21.00	11.92
Klinë	23.68	38.89
Fushë Kosovë	32.55	100.00
Kamenicë	18.00	10.00
Mitrovicë	93.33	100.00
Leposaviq	-	-
Lipjan	16.60	54.91
Novobërdë	13.15	100.00
Obiliq	16.74	0.06
Rahovec	36.84	28.57
Pejë	19.09	100.00
Podujevë	17.59	100.00
Prishtinë	16.57	76.19
Prizren	63.80	23.75
Skenderaj	17.85	75.56
Shtime	26.92	43.00
Shtërpçë	5.95	100.00
Suharekë	14.77	29.00
Ferizaj	67.02	63.83
Viti	17.51	22.20
Vushtrri	5.55	100.00
Zubin potok	-	-
ZAMV	-	-
Malishevë	1.75	100.00
Hani i Elezit	30.33	100.00
Mamushë	63.64	85.71
Junik	35.86	100.00
Klllokot	32.94	-
Graçanicë	36.74	100.00
Ranillug	11.66	100.00
Partesh	12.76	100.00
Zveçan	-	-




Histogrami Nr.23. Trotuaret

2.9. Transporti Publik komunal

Në tabelën 9 në treguesit matës për transportin publik janë paraqitur përqindja e fshatrave të përfshirë në transportin publik (74.69) dhe përqindja e vendndalimeve për autobus të pajisura me shenjëzim (55.95%). Tek treguesi i parë matës komunitat që qëndrojnë më së miri janë: Gllogoc, Obiliq, Pejë, dhe Mamushë, ndërsa tek treguesi i dytë, komunitat: Lipjan, Novobërdë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit dhe ZAMV.

Tabela 9: Transporti Publik komunal

Parkingjet publike	% e fshatrave të përfshirë në transportin publik komunal	% e vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim
Mesatarja	74.69	55.95
Deçani	91.89	23.68
Gjakovë	82.42	45.63
Gllogoc	100.00	67.00
Gjilan	80.95	32.35
Dragash	50.00	0.00
Istog	94.00	75.00
Kaçanik	90.32	56.67
Klinë	94.44	66.67
Fushë Kosovë	93.75	92.31
Kamenicë	79.31	16.95
Mitrovicë	91.30	35.48
Leposaviq	-	-
Lipjan	90.32	100.00
Novobërdë	66.67	100.00
Obiliq	100.00	27.34
Rahovec	88.24	50.00
Pejë	100.00	71.88
Podujevë	94.87	29.35
Prishtinë	95.45	96.71
Prizren	90.67	69.12
Skenderaj	96.30	65.63
Shtime	91.30	82.35
Shtërpçë	62.50	61.54
Suharekë	90.48	51.43
Ferizaj	95.56	22.09
Viti	61.54	32.00
Vushtrri	88.06	62.20%
Zubin potok	-	-
ZAMV	-	100.00
Malishevë	95.45	60.00
Hani i Elezit	27.27	100.00
Mamushë	100.00	100.00
Junik	33.33	100.00
Klllokot	0.00	37.50
Gračanicë	0.00	0.00
Ranillug	23.08	33.33
Partesh	-	-
Zvečan	-	-




Histogrami Nr.24. Transporti publik komunal

2.10. Parkingjet publike

Në tabelën 10 në treguesit matës për parkingjet publike janë prezantuar numri i parkingjeve publike (2627), numri i parkingjeve publike të shenjëzuara (1798), numri total i vendparkimeve publike (24,619), përqindja e parkingjeve publike me shenjëzim (81.05%) dhe përqindja e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara (53.21%).

Tabela 10: Parkingjet publike

Komunat	Numri total i parkingjeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve)	Numri total i parkingjeve publike të shenjëzuara (në rrugë dhe jashtë rrugëve)	Numri total i vendparkimeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve)	% e parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal	% e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara
Mesatarja	2.627	1.798	24.619	81.05	53.21
Deçan	3	3	90	100.00	66.67
Gjakovë	8	8	160	100.00	62.50
Glllogoc	14	13	611	92.86	65.00
Gjilan	364	14	364	85.71	71.43
Dragash	13	3	150	23.08	-
Istog	14	14	300	100.00	14.29
Kaçanik	7	3	210	42.86	28.57
Klinë	2	2	182	100.00	50.00
Fushë Kosovë	12	12	650	100.00	100.00
Kamenicë	6	6	6	100.00	100.00
Mitrovicë	1230	950	400	77.24	4.23
Leposaviq	-	-	-	-	-
Lipjan	16	16	610	100.00	31.25
Novobërdë	2	2	2	100.00	100.00
Obiliq	8	5	180	62.50	100.00
Rahovec	4	4	200	100.00	100.00
Pejë	210	210	210	100.00	43.48
Podujevë	32	26	2650	81.25	28.13
Prishtinë	234	234	11540	100.00	15.81
Prizren	170	120	288	77.69	5.38
Skenderaj	7	7	424	100.00	57.14
Shtime	10	5	700	100.00	50.00
Shtërpçë	4	-	122	25.00	50.00
Suharekë	30	10	1500	33.33	50.00
Ferizaj	109	56	722	51.38	8.26
Viti	7	7	3	100.00	57.14
Vushtrri	31	31	846	100.00	70.97
Zubin potok	-	-	-	-	-
ZAMV	-	-	-	-	-
Malishevë	1	1	70	100.00	-
Hani i Elezit	4	2	150	75.00	-
Mamushë	3	3	9	100.00	-
Junik	3	3	20	100.00	-
Kllokot	-	-	-	-	-
Gračanicë	46	6	1250	23.91	-
Ranillug	23	-	-	-	-
Partesh	-	-	-	-	-
Zveçan	-	-	-	-	-




Histogrami Nr.25. Parkingjet Publike

2.11. Ndriçimi Publik

Në tabelën 11 në treguesit matës për ndriçimi publik është paraqitur përqindja e kilometrave rrugë me ndriçim publik në zonën urbane (54.26%), zonën rurale (24.99%).

Tabela 11: Ndriçimi Publik

Komunat	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total a. Në zonën urbane	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total b. Në zonën rurale / fshatra	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total, në qytet dhe në zonën rurale / fshatra
Mesatarja	54.26	23.15	24.99
Deçan	26.50	7.82	9.94
Gjakovë	90.00	36.00	42.81
Glllogoc	42.22	-	8.09
Gjilan	37.22	36.62	36.89
Dragash	58.33	3.27	5.14
Istog	47.73	2.63	8.33
Kaçanik	16.32	0.00	4.52
Klinë	80.00	22.75	29.98
Fushë Kosovë	55.56	57.14	56.25
Kamenicë	78.26	14.56	20.96
Mitrovicë	93.33	27.27	65.38
Leposaviq	-	-	-
Lipjan	49.78	4.56	7.56
Novobërdë	3.85	0.88	1.88
Obiliq	24.00	4.00	7.33
Rahovec	78.43	5.32	15.55
Pejë	40.39	6.72	21.35
Podujevë	58.82	0.63	8.65
Prishtinë	98.41	20.95	57.91
Prizren	54.22	25.58	40.23
Skenderaj	12.84%	26.33	14.11
Shtime	43.33%	1.50	11.15
Shtërpçë	89.66%	47.55	51.43
Suharekë	67.50%	4.15	8.60
Ferizaj	63.35%	5.13	22.80
Viti	5.63%	100.00	9.18
Vushtrri	76.36	4.36	15.94
Zubin potok	-	-	-
ZAMV	-	-	-
Malishevë	2.25	3.00	2.40
Hani i Elezit	66.71	1.97	13.40
Mamushë	88.46	0.00	11.50
Junik	67.01	0.00	25.60
Klllokot	100.00	100.00	100.00
Graçanicë	-	65.12	65.12
Ranillug	-	35.71	-
Partesh	20.00	-	151.00
Zveçan	-	-	-




Histogrami Nr.26. Ndriçimi Publik

2.12. Furnizimi me ujë

Në tabelën 12 në treguesit matës të shërbimi i furnizimit me ujë janë paraqitur përqindja e ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujësjellësit (67.41%), përfshirja vendbanimeve (61.21%), pagesat e ujit (67.40%) dhe përqindja e faturimit të ujit të pijshëm (53.59%).

Tabela 12: Furnizimi me ujë

Komunat	% e ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujësjellësit	% e vendbanimeve të pajisura/përfshira - me sistem të ujësjellësit	% e pagesave të ujit	% e faturimit të ujit të pijshëm
Mesatarja	67.41	61.21	67.40	53.59
Deçan	0.00	56.76	58.66	17.72
Gjakovë	0.00	46.15	74.11	30.02
Glllogoc	39.70	44.74	64.69	52.00
Gjilan	79.74	33.33	70.59	41.26
Dragash	100.00	5.56	79.23	50.70
Istog	90.32	92.31	68.99	39.21
Kaçanik	40.98	19.00	80.00	71.43
Klinë	66.67	42.59	80.18	66.56
Fushë Kosovë	89.34	75.00	74.84	99.46
Kamenicë	35.58	3.45	76.89	55.01
Mitrovicë	94.56	86.96	67.45	58.37
Leposaviq	-	-	80.18	66.56
Lipjan	64.55	50.00	76.05	50.82
Novobërdë	-	58.33	-	-
Obiliq	68.39	83.33	-	-
Rahovec	-	76.47	-	-
Pejë	100.00	100.00	89.09	35.05
Podujevë	80.16	53.85	70.02	100.00
Prishtinë	93.32	65.91	77.75	54.62
Prizren	82.37	94.59	73.91	3.61
Skenderaj	50.81	38.89	-	-
Shtime	80.42	78.26	60.00	52.00
Shtërpçë	94.73	75.00	85.66	85.63
Suharekë	51.52	24.39	56.72	43.23
Ferizaj	84.96	88.89	59.03	45.51
Viti	26.78	46.15	-	58.94
Vushtrri	-	43.28	45.24	35.34
Zubin potok	-	-	-	-
ZAMV	-	100.00	-	-
Malishevë	43.48	36.36	84.34	40.00
Hani i Elezit	58.26	54.55	44.33	0.03
Mamushë	100.00	100.00	-	-
Junik	56.31	100.00	57.27	83.74
Klllokot	58.68	50.00	-	-
Graçanicë	89.71	75.00	60.25	63.84
Ranillug	85.48	76.92	-	-
Partesh	82.95	66.67	4.52	100.00
Zveçan	-	-	-	-




Histogrami Nr.27. Furnizimi me ujë

2.13. Kanalizimi

Në tabelën 13 në treguesit matës të shërbimit të kanalizimit janë paraqitur numri i ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit në zona urbane (89.57%), numri i ekonomive familjare të kyçura në zona rurale (58.77%), numri vendbanimeve që posedojnë kanalizim (64.78%).

Tabela 13: Kanalizimi

Komunat	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: a. Zona Urbane	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: b. Zona Rurale	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: c. Totali	% e vendbanimeve në komunë të cilat posedojnë sistemin e ujërave të zeza - kanalizimeve
Mesatarja	89.57	58.77	68.58	64.78
Deçan	-	-	-	-
Gjakovë	92.00	20.00	56.00	49.45
Gillogoc	90.62	66.86	73.62	73.68
Gjilan	99.33	36.41	76.02	23.81
Dragash	95.30	10.04	19.00	0.00
Istog	28.41	21.95	25.32	28.85
Kaçanik	94.81	56.41	71.01	29.03
Klinë	100.00	41.76	56.79	57.41
Fushë Kosovë	97.50	97.61	97.54	100.00
Kamenicë	100.00	41.76	56.79	50.00
Mitrovicë	100.00	64.32	82.76	84.78
Leposaviq	-	-	-	-
Lipjan	100.00	57.89	64.54	56.45
Novobërdë	66.75	57.14	63.00	41.67
Obiliq	100.00	87.77	90.00	94.44
Rahovec	-	-	65.23	94.12
Pejë	100.00	100.00	100.00	15.38
Podujevë	100.00	80.61	88.37	74.36
Prishtinë	100.00	22.72	86.23	65.91
Prizren	79.74	100.00	82.37	83.78
Skenderaj	100.00	16.37	31.10	25.93
Shtime	93.29	77.41	81.92	78.26
Shtërpçë	85.19	41.21	52.77	81.25
Suharekë	100.00	87.96	90.35	85.37
Ferizaj	96.61	90.16	92.83	95.56
Viti	58.82	18.67	21.95	35.90
Vushtrri	100.00	56.77	74.51	83.58
Zubin potok	-	-	-	-
ZAMV	-	-	-	-
Malishevë	50.29	41.92	47.08	61.36
Hani i Elezit	100.00	80.371	100.00	63.64
Mamushë	100.00	-	100.00	100.00
Junik	56.13	100.00	56.30	33.33
Killokot	100	59.88	71.76	75.00
Graçanicë	-	82.34	82.34	100.00
Ranillug	-	22.07	22.07	30.77
Partesh	-	83.64	83.64	100.00
Zveçan	-	-	-	-




Histogrami Nr.28. Kanalizimi

2.14. Grumbullimi i Mbeturinave

Në tabelën 14 në treguesit matës të shërbimit të mbeturinave janë paraqitur përqindja e ekonomive familjare kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave (60.99%), përqindja e vendbanimeve të përfshira në këtë shërbim (64.19%) dhe përqindja e pagesave për këtë shërbim (62.12%).

Tabela 14: Grumbullimi i Mbeturinave

Komunat	% e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	% e pagesave të bëra
Mesatarja	60.99	64.19	62.12
Deçan	48.78	32.43	64.68
Gjakovë	72.75	47.37	66.00
Glogoc	46.81	18.00	60.00
Gjilan	53.29	45.24	62.00
Dragash	39.11	58.33	66.10
Istog	18.67	51.92	86.58
Kaçanik	58.20	51.61	60.99
Klinë	41.76	18.52	60.94
Fushë Kosovë	100.00	100.00	66.67
Kamenicë	34.90	12.07	53.80
Mitrovicë	99.19	89.13	64.37
Leposaviq	-	-	-
Lipjan	26.73	54.84	53.45
Novobërdë	78.56	81.82	43.45
Obiliq	33.99	50.00	60.00
Rahovec	69.49	44.12	57.69
Pejë	99.69	94.87	62.47
Podujevë	65.00	44.87	77.11
Prishtinë	71.23	43.18	68.56
Prizren	73.46	90.54	70.72
Skenderaj	8.44	29.63	55.36
Shtime	84.34	73.91	66.92
Shtërpçë	67.52	81.25	79.93
Suharekë	81.57	82.93	59.47
Ferizaj	75.45	75.56	66.97
Viti	-	-	-
Vushtrri	29.08	41.79	57.43
Zubin potok	-	-	-
ZAMV	-	-	-
Malishevë	37.66	40.91	50.40
Hani i Elezit	65.22	63.64	54.56
Mamushë	31.80	100.00	90.00
Junik	100.00	100.00	100.00
Kilokot	100.00	100.00	-
Gračanicë	100.00	100.00	40.74
Ranillug	100.00	100.00	20.32
Partesh	-	100.00	33.42
Zveçan	-	-	-



Histogrami Nr.29. Grumbullimi i mbeturinave

2.15. Deponimi i Mbeturinave

Në Kosovë mesatarja e mbeturinave të deponuara për kokë banori për vitin 2013 është 155.20 kilogramë. Mesatarja e deponimit të mbeturinave në këtë rast është llogaritur vetëm për komunat të cilat kanë raportuar këtë tregues matës.

Grafikoni: Nr. 15 Deponimi i mbeturinave



Histogrami Nr.30. Mesatarja e mbeturinave të deponuara për kokë banori në vitin 2013

III. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT KOMUNAL PËR NEGOCIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT JANAR – DHJETOR 2013

Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PVMSA) paraqet dokumentin kyç strategjik të Qeverisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Në këtë rol, Plani i Veprimit për MSA-në është pasues i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) dhe ndërtohet mbi përvojën dhe mekanizmat institucionale të themeluar përgjatë viteve. Plani i Veprimit për MSA-në përbëhet prej 200 masave, prej të cilave 47 janë nën kapitullin e kriterëve politike, 19 nën kapitullin e kriterëve ekonomike dhe 133 nën aftësitë për të marrë përsipër detyrimet që rezultojnë nga MSA. Implementimi i këtyre masave ka për qëllim përmbushjen e kriterëve për fillimin e negociatave për MSA-në dhe zbatimin e detyrimeve që do të merren përsipër nga MSA-ja. Në këtë kontekst, ofrimi i të dhënave nga komunat për zhvillimin e aktiviteteve të tyre është mjaft i rëndësishëm dhe domethënës, marrë parasysh përgjegjësinë dhe kompetencat për rregullimin e një numri të gjere të funksioneve publike.

Kjo pjesë e raportit nënvizon kontinuitetin e punës së komunave, të arriturat dhe paraqitjen e sfidave drejt përmbushjes së obligimeve dhe përgjegjësi të nivelit lokal të qeverisjes. Fokus i veçantë i është dhënë ofrimit informativ rreth forcimit të kapaciteteve të administratës së nivelit lokal (përfshirë komunat e sapoformuara) përmes udhëzimeve, këshillave dhe rregullave të ofruara nga niveli qendror, pastaj informatave për sigurimin e qasjes në arsim dhe luftimin e braktisjes së shkollimit, decentralizimin e fondit për ri-integrim, hartimin e politikave, planeve dhe programeve zhvillimore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural. Po ashtu, raporti përfshinë të dhëna rreth përmirësimit të infrastrukturës në zonat rurale, shfrytëzimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, auditimin e brendshëm, menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK) në sektorin publik sipas standardeve dhe praktikave ndërkombëtare. Pjesa e fundit e këtij kapitulli ofron informata për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimin e politikave mjedisore.

3.1. Kriteret politike

Përmbushja e kriterëve politike është obligim i cili duhet përmbushur nga shtetet kandidate dhe shtetet kandidate potenciale për anëtarësim në BE. Këto kriterë kanë për qëllim të sigurojnë stabilitetin e institucioneve të cilat do të garantojnë demokracinë, qeverisjen e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e të drejtave të pakicave.

Së këndejmi, një nga fushat kryesore që ndërlidhen me kriterin politik është edhe administrata në nivelin lokal. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal është më se i domosdoshëm ngase mundëson që të ketë kapacitete efektive administrative të cilat drejtëpërsëdrejti do të ndikojnë në zbatimin e obligimeve që sjellë anëtarësimi në BE.


Sa i përket aktiviteteve të komunave në këtë fushë, ato kanë qenë të obliguara të raportojnë për aktivitetet e tyre në forcimin e kapaciteteve të administratës lokale dhe ndikimin e udhëzimeve të nivelit qendror në atë lokal. Sipas të dhënave, zhvillimi i administratës në nivelin komunal ka vazhduar edhe në vitin 2013. Niveli qendror ka ofruar udhëzime të shumta për komunat, përfshirë këshillat ligjore dhe konsultimet paraprake. Po ashtu, janë ofruar udhëzimet e nevojshme për rregulloret në fuqi të nivelit qendror, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve administrative në komuna. Të dhënat e ofruara nga komunat pasqyrojnë vlerën numerike të pranimit të udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të qeverisë nga niveli qendror⁷. Nga të dhënat e siguruar del se

⁷ Disa nga udhëzimet e ofruara nga Ministritë për nivelin lokal:

- U.A.01/2011 për Menaxhimin dhe Përdorimin e Internetit në Institucionet e Republikës së Kosovës;
- U.A.03/2011 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike;
- U.A.02/2010 për Menaxhimin e Sigurisë Informative;
- U.A.03/2010 për Përdorimin e Softuerit dhe Harduer-it;
- U.A.04/2010 për Shfrytëzimin e Postës Elektronike Zyrtare;

prej 33 komunave, vetëm 14 prej tyre kanë pranuar udhëzime administrative dhe rregullore nga niveli qendror. Krahas tyre, 10 komuna kanë ofruar përgjigje të përgjithësuar, 4 komuna nuk kanë marrë udhëzime administrative dhe rregullore, kurse 5 komuna nuk janë përgjigjur fare. Numri i përgjithshëm i udhëzimeve administrative të pranura nga komunat është 143, kurse i rregulloreve 31.

Lidhur me trajnimet e mbajtura, numri i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën. Prej 38 komunave, përgjigje kanë ofruar 23 komuna. Numri total i trajnimeve të mbajtura nga komunat është 205, ndërsa ato të ofruara nga ministritë është 173. Pra, nga të dy nivelet janë mbajtur gjithsej 378 trajnime. Sa i përket numrit të pjesëmarrësve në trajnime, nga to kanë përfituar 1172 zyrtarë komunal.



Histogrami Nr.31. Numri i trajnimeve të ofruara nga komuna dhe ministritë

Komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë informacion për numrin e trajnimeve janë: Fushë-Kosova, Gjakova, Glllogovci, Istogu, Rahoveci, Suhareka, Hani i Elezit, Mamusha, Klokoti, Parteshi, Ranillugu dhe Graçanica.

Sa i përket performancës në punë të punonjësve civil dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarë, të gjitha komunat kanë dhënë vlerësimin pozitiv se është arritur nivel i kënaqshëm i ofrimit të shërbimeve, ku përdorimi i teknologjisë informative ka mundësuar qasje më të lehtë në këtë aspekt. Po ashtu, të gjitha komunat kanë ndërmarrë veprime për thjeshtësimin e procedurave administrative dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së tyre. Ato janë mbështetur nga institucionet qendrore përmes instalimit të programeve të avancuara (data-bazave), që kanë rezultuar në administrimin e mirë të lëndëve. Tani qytetarët pajisen me ekstraktet e gjendjes civile me një procedurë të përsheptuar, përmes lansimit të programit të veçantë nga niveli qendror.

Përveç atyre që u përmendën më lartë, në çështjen e ngritjes dhe rritjes së besueshmërisë së dokumenteve të lëshuara, komunat kanë dhënë vlerësimin se ekziston një siguri e lartë e ruajtjes dhe lëshimit të dokumenteve.

- U.A.03/2011 për Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komuna;
- U.A.02/2011 për Përcaktimin e Procedurave për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve;
- U.A.09/2008 për Transparencë në Komuna;
- U.A.08/2008 për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane;
- U.A.08/2008 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna;
- U.A.2005/08 për Përcaktimin e Kompetencës dhe Përshkrimin e Detyrave të Punës të Zyrtarit për Barazi Gjinore;
- Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Shërbyesit Civil;
- U/A NR.01/2013 për Dokumentet e Gjendjes Civile;
- U/A Nr.03/2013 për Vulën Verifikuese;
- U.A.Nr.2011/03 për Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrave për Qytetarët në Komuna;
- U.A. 2012/1 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave përmes Teknologjisë informative - "Teleprezencave"

3.2. Të drejtat e njeriut

3.2.1. Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJD NJK)

NJD NJK kanë emërtim të njëjtë në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 2011/04 për Njësitë Komunale për të Drejta të Njeriut. Këto Njësi janë funksionale në të gjitha komunat, me përjashtim të Komunës së Vitisë dhe Novobërdës, të cilat kanë vetëm zyrtarin për barazi gjinore. Nga 35 Njësi, 28 prej tyre funksionojnë në kuadër të drejtorisë për administratë në komunë, ashtu siç përcaktohet me nenin 8.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2011/04, kurse 7 prej tyre i përgjigjen kryetarit të komunës.

Përbërja e NJD NJK-ve është e ndryshme nëpër komuna. Në 24 komuna, NJD NJK-të kanë nga 3 zyrtarë, në 5 komuna kanë nga 2 zyrtarë, në 2 komuna nga 4 zyrtarë, kurse në Komunën e Vitisë, Mamushës dhe Novobërdës janë vetëm zyrtarët për barazi gjinore.

Me rregullat e udhëzimit administrativ të lartpërmendur, zyrtarët e NJD NJK-ve nuk duhet të kenë detyra shtesë. Prej pozitave të cilat parashihen në këto njësi, ajo e zyrtarit për barazi gjinore mbetet më e preferuara dhe më e qëndrueshme. Kjo ndoshta për faktin se këta zyrtarë kanë pozitën e koordinatorit të njësisë dhe nuk janë të ngarkuar me detyra shtesë. Pothuajse shumica e komunave aktivitetet e tyre i kanë të bollshme në fushën e barazisë gjinore, që do të thotë se përkushtimi i koordinatorit është i orientuar kah barazia gjinore. Kjo pozitë është stabile dhe për këta zyrtarë siguron vendin e punës brenda institucionit. Vetëm në tri komuna, zyrtarët e NJD NJK-së nuk kanë detyra të tjera shtesë. Në të komunat e tjera, në pamundësisë të rekrutimit të stafit të ri, për shkak të numrit të kufizuar të punëtorëve dhe buxhetit të limituar, zyrtarët e NJD NJK-ve janë të ngarkuar me punë të tjera shtesë. Në pajtim me nenin 6 pika 1.3 dhe 4 të U.A. Nr. 2011/04 për ndryshimin e U.A. Nr. 2008/02 për themelimin e NJD NJK-ve, zyrtarët kanë përshkrimin specifik të detyrave të punës.

Krahas organizimit dhe funksionimit të NJD NJK-ve, në shumë komuna ato ende nuk janë inkorporuar në Statutet Komunale për shkak të hartimit të tyre para themelimit të Njësiteve. Edhe pse e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 10 të U.A. Nr.2011/04, NJD NJK-të nuk kanë linjë të veçantë buxhetore. Aktivitetet e tyre i kryejnë duke aplikuar në projekte të cilat aprovohen duke u bazuar në prioritetet e komunës. Kurse, në Komunën e Novobërdës, Pejës, Fushë-Kosovës dhe Istogut, zyrtarët për barazi gjinore të cilët janë njëkohësisht edhe koordinatori të NJD NJK-ve, kanë arritur të sigurojnë linjë të veçantë buxhetore për aktivitetet për barazi gjinore.

Komunat duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e rregullt të koordinatorit në takimet e stafit të lartë, në panelet rekrutuese, grupet punuese dhe hartimin e legjislacionit dhe politikave komunale. Koordinatorët, me përjashtim të një numri të vogël të komunave, nuk ftohen asnjëherë në këto takime. Zyrtarët e NJD NJK-së, gjegjësisht koordinatori i ZBGJ-së dhe zyrtari për komunitete janë pjesë e paneleve intervistuese, mirëpo në të shumtën e rasteve në cilësinë e vëzhguesit.


3.2.2. Barazia gjinore

Ligji për Barazi Gjinore ka për qëllim mbrojtjen, trajtimin dhe vendosjen e barazisë si vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë. Ligji parashihet përcaktimin masave të përgjithshme dhe të veçanta për garantimin e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton subjektet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për hartimin dhe zbatimin e akteve normative për zhvillimin e barazisë gjinore në shoqëri. Me qëllim që të respektohet dhe zbatohet barazia gjinore në nivelin lokal, që nga viti 2003 në të gjitha komunat është emëruar zyrtari për barazi gjinore.

Sa i përket përfaqësimit gjinor në Kuvendet e Komunave, stafi politik është i përfaqësuar sipas kuotave të parapara me ligj. Megjithatë, në 38 komuna vetëm 3 femra janë zgjedhura kryesuese të kuvendeve të komunave dhe atë në Komunën e Pejës, Novobërdës dhe Mamushës. Gjithashtu, dy femra mbajnë pozitën e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete, në: Komunën e Mitrovicës e cila është e përkatësisë turke dhe në Komunën e Ranillugut e përkatësisë serbe. Pra, sa i përket radhitjes së femrës në pozita vendimmarrëse, femrat janë të përfaqësuara me 4.66 %.

Për dallim nga pozitat politike, përfaqësimi i femrës në shërbimin civil në komuna është 28.99%.


Në vijim është paraqitur histogrami me 10 komunat me përqindjen më të lartë të punësimit të femrave në shërbimin civil (sipas të dhënave të Departamentit për Shërbim Civil të MAP-it):



Histogrami Nr.32. Dhjetë komunat me përqindjen më të lartë të punësimit të femrave në shërbimin civil

Sipas histogramit të mësipërm, përqindjen më të lartë të fermave në shërbimin civil e ka Komuna e Glllogovcit me 72 %, pastaj Komuna e Mitrovicës Veriore me 62.7 %, Zveqani me 49.1%, Zubin Potoku me 47.8%, Obiliqi 39.8%, Leposaviqi 37.8 %, Graçanica me 37.7%, Fushë-Kosova me 36%, Prishtina 34% dhe Shtimja 29.8%.

Në anën tjetër, komunat të cilat qëndrojnë më dobët me punësimin e femrave në shërbimin civil janë: Hani i Elezit me 7%, Dragashi 9%, Rahoveci 12.6 %, Juniku 14.5%, Malisheva 16.1%, Novobërda 17.6%, Parteshi 16.1%, Kaçaniku 17.2% dhe Skenderaj 19.4%.



Histogrami Nr.33. Dhjetë komunat me përqindjen më të ulët të punësimit të femrave në shërbimin civil

Krahas punësimit, komunat kanë raportuar se të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera komunale janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për barazi gjinore. Por, vetëm 6 komuna kanë nxjerrë rregulloret për barazi gjinore: Kamenica, Novobërda, Ranillugu, Shtërpca, Hani i Elezit, Kllokoti dhe Novobërda. Sa u përket zyrtarëve për barazi gjinore, në 34 komuna 26 zyrtarë nuk janë të ngarkuar me detyra shtesë, kurse 9 prej tyre kryejnë edhe detyra të tjera.

3.2.3 Dhuna në familje

Shënimet flasin se dhuna familjare është evidente dhe mjaft e theksuar. Krahasuar me periudhat e mëparshme, të dhënat nga raportet e NJDNJK-ve konstatojnë se është arritur progres në vetëdijësimin e opinionit për luftimin e kësaj dukurie. Organizimi i fushatave vetëdijësuese për mbrojtjen nga dhuna në familje, ka ndikuar që qytetarët të fitojnë besimin në institucione dhe t'i lajmërojnë rastet e dhunës në familje. Në paraqitjen e kësaj dukurie ndikojnë shumë faktorë, por më së shumti gjendja e vështirë ekonomike e shoqërisë dhe trajtimi tradicional i problemeve familjare. Rastet e raportuara kryesisht lidhen me ushtrimin e dhunës ndaj gruas, por ka edhe raste të raportimit të dhunës nga burrat. Dhuna është ushtruar edhe ndaj prindit, vëllezërve dhe fëmijëve.

Përkundër faktit që raportet e komunave nuk flasin saktë për rastet e dhunës në shkolla, ato janë mjaft evidente, konsiderohen në rritje dhe me pasoja të mëdha. Gjithashtu, janë prezente rastet recidiviste të ushtruesve të dhunës nëpër shkolla.

Sa i përket trajtimit të viktimave të dhunës në familje, ende ka vështirësi në këtë drejtim, e sidomos strehimi i tyre. Megjithatë në nivel regjional ekziston Qendra për Strehimin e Viktimave të Dhunës, përkrahja e viktimave është jo e qëndrueshme, sepse strehimi i tyre mundësohet vetëm për 6 muaj. Për strehimin e tyre kryesisht janë shfrytëzuar shtëpitë e sigurta.

Konform Ligjit Kundër Dhunës në familje, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë krijuar mekanizmat për zbatimin e ligjit, siç është Grupi Koordinues Kundër Dhunës në Familje. Ndërsa, për parandalimin e kësaj dukurie, komunat kanë organizuar mjaft aktivitete. Ndër aktivitetet e NJDNJK-ve që mund të përmenden janë: fushatat për vetëdijësimin për


lajmërimin e rasteve të dhunës në organet përgjegjëse, trajnime për parandalim e dhunës në familje, këshillime, shpërndarje të fletëpalosjeve, ligjërata për nxënës të shollave etj.

3.2.4. Të drejtat e komuniteteve

Të drejtat dhe liritë e komuniteteve janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Trajtimi i tyre është pjesë e të gjitha politikave shtetërore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton pjesëmarrje efektive në vendimmarrje, politikë dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes, përmes përfaqësimit në të gjitha organet shtetërore. Në nivelin lokal komunat ofrojnë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim. Sipas të dhënave të komunave, deri tani nuk ka pasur asnjë ankesë nga komunitetet për ndonjë padrejtësi, ose vendim diskriminues të organeve komunale mbi bazën e përkatësisë etnike. Të drejtat e komuniteteve janë respektuar në mënyrë të barabartë në të gjitha proceset vendimmarrëse në komuna. Kjo është reflektuar edhe gjatë monitorimit të procesit të rekrutimit të stafit, ku nuk është evidentuar ndonjë shkelje e të drejtave të aplikantëve. Me rastin e shpalljes së vendeve të lira të punës, komunat në të shumë raste u bëjnë thirrje për aplikim komuniteteve, madje në mungesë të interesimit të tyre konkurset janë përsëritur disa herë. Sipas të dhënave të DSHC të MAP-it, në shërbimin civil komunal nga 6474 punëtorë të administratës komunale, 1139 janë nga komunitetet joshumicë, që në përqindje është 17.59%.

Krahas kësaj, komunat kanë siguruar përfaqësimin e komuniteteve në strukturat komunale konform neneve 54 dhe 61 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ku është përcaktuar se në komunat ku jetojnë të paktën 10% e komuniteteve jo shumicë, komuniteti përfaqësohet në të gjitha strukturat komunale. Komunat kanë ndërmarrë hapa për hartimin e politikave lokale për sigurimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë. Kësisoj, komunat kanë hartuar dhe zbatojnë Planin e Veprimit për Integrimin e Komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Me gjithë përpjekjet e komunave për përmirësimin e mirëqenies së këtij komuniteti, problemet kryesisht janë paraqitur në zgjidhjen e çështjes së banimit dhe strehimit të tyre për shkak të mungesë të pronës, pastaj integrimi i tyre në rrethin shoqëror, gjithpërfshirja e fëmijëve në arsim, braktisja e shkollimit nga fëmijët, si dhe punësimi i tyre për shkak të mungesës së kualifikimit.

Tani ekziston një evidencë e familjeve që banojnë në kushte të rënda ekonomike. Sipas të dhënave janë të identifikuar gjithsej 516 familje me kushte të rënda, prej të cilave 130 romë, 66 ashkali dhe 76 egjiptianë. Përveç kësaj, ka të dhëna të prezantuara nga komunat që nuk specifikojnë përkatësinë etnike të këtyre familjeve, por raportohen si tërësi. Të tilla janë të dhënat për 188 familje me kushte të rënda në Komunën e Prizrenit, pastaj 500-600 familje në Komunën e Pejës. Ndryshe nga to, në komunat: Malishevë, Vushtri, Lipjan, Obiliq, Pejë, Shtërpçë dhe Ferizaj, është raportuar për strehimin e 208 familjeve me 791 anëtarë. Një pjesë e komunave janë përkujdesur gjithashtu për strehimin e 208 familjeve me 791 anëtarë, të cilët nuk kanë pronë të vetën, mirëpo këto të dhëna nuk përfshijnë të gjitha komunat prandaj nuk konsiderohen definitive.



Histogrami Nr.34. Familjet të cilat jetojnë në kushte të rënda nga radhët e komuniteteve.

Në të drejtat themelore të njeriut bënë pjesë edhe ushtrimi i lirive fetare. Komuniteteve në Kosovë u garantohet liria fetare dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore. Trashëgimia kulturore, fetare dhe monumentet e të gjitha komuniteteve, si pjesë trashëgimisë shtetërore, mbrohen në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kur flitet për këto të drejta, komunat kanë hartuar politika të cilat promovojnë dhe ndihmojnë lirinë fetare. Në këtë drejtim, shumica e komunave kanë hartuar Planin Zhvillimor për Adresimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare, përderisa një pjesë e tyre i kanë përfshirë në Planin Zhvillimor të Komunës.

3.2.5. Përdorimi i gjuhëve

Përdorimi i gjuhëve në komuna rregullohet me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Me këtë ligj janë paraparë obligimet e organeve të institucioneve lokale për respektimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, si dhe gjuhëve në përdorim zyrtar. Sipas nenit 35 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe nenit 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi i komunës obligohet të nxjerrë rregullore për përdorimin e gjuhëve. Po ashtu, MAPL ka nxjerr Udhëzimin Administrativ Nr. 2011/02 për Procedurat për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Sa i përket këtyre obligimeve, në të gjitha komunat janë miratuar rregulloret komunale për përdorimin e gjuhëve.

Sa i përket përdorimit të gjuhëve, të gjitha komunitetet, gjuha e të cilëve është gjuhë në përdorim zyrtar, paraqesin kërkesat në gjuhën e tyre. Deri tani nuk është adresuar asnjë ankesë për shkeljen e kësaj të drejte nga komunitetet. Në përputhje të nenit 9.1 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në shumicën e komunave janë të vendosura mbishkrimet në gjuhët zyrtare, si dhe emrat e vendbanimeve. Mirëpo, në disa komuna mbishkrimet janë vendosur vetëm në njërën gjuhë, siç është: Graçanica, Ranillugu dhe Parteshi.

Gjithashtu, institucionet dhe organet komunale mundësojnë komunikim dhe ofrojnë shërbime dhe dokumente publike në gjuhët zyrtare dhe sipas kërkesës së palës. Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në punë, debate, takime, komisione komunale, procedura administrative dhe sipas kërkesës së palës dokumentet përkthehen edhe në gjuhët e komunitetit, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare.

Organizimi i nevojave për përkthim dallon nëpër komuna. Kështu, në 17 komuna janë të themeluara njësitë e veçanta për përkthim, si në: Kllokot, Dragash, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Istog, Mitrovicë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Podujevë, Shtërpçë, Vushtrri, si dhe në Zyrën Administrative të Mitrovicës Veriore. Ndryshe nga to, 15 komuna nuk kanë Njësi për Përkthim, por kanë zyrtarë për përkthim. Në këtë grup hyjnë: Deçani, Mamusham Gillogoci, Fushë-Kosova, Graçanica, Juniku, Lipjani, Malisheva, Novobërda, Obiliqi, Ranillugu, Suhareka, Kaçaniku, Kamenica dhe Klina. Kurse, komunat të cilat nuk kanë dhënë informata janë: Skenderaj dhe Vitia.

Ligji mundëson edhe njohjen e gjuhës tradicionale të një komuniteti si gjuhë në përdorim zyrtar. Mirëpo, deri tani në komuna nuk ka pasur ndonjë kërkesë për njohjen e gjuhës së folur tradicionalisht si gjuhë në përdorim zyrtar.

5.2.6. Të drejtat e fëmijëve


Republika e Kosova është e njohur si një ndër shtetet me popullatën më të re në Evropë, andaj misioni i saj është të arrijë të përmbushen standardet për mbrojtjen dhe respektimin e interesave më të larta të fëmijëve. Mu për këtë janë krijuar mekanizma me detyrën për të siguruar zbatimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është shtrirë edhe në nivelin lokal të qeverisjes. Komunat kanë një numër të obligimeve për të siguruar respektimin e të drejtave të fëmijëve. Në Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve parashihet që komunat të caktojnë zyrtarin për të drejtat e fëmijëve, pa detyra shtesë. Mirëpo, nga monitorimi i komunave është parë se zyrtarët për të drejtat e fëmijëve në shumicën prej tyre janë të ngarkuar me detyra shtesë, andaj kjo vështirëson në masë të madhe zbatimin e strategjive, politikave standarde për fëmijët. Në vetëm 8 komuna këta zyrtarë nuk kanë detyra shtesë, si në: Dragash, Mitrovicë, Klinë, Istog, Gjilan, Obiliqi, Podujevë dhe Skenderaj.

Një ndër të drejtat themelore të fëmijëve është arsimimi i tyre. Me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, shkollimi i detyrueshëm fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë vjeçare. Parimisht, vijimi i shkollimit nga ana e nxënësit është përgjegjësi e prindit, mirëpo roli kryesor u mbetet komunave dhe institucioneve të tjera arsimore. Lidhur me vijueshmërinë e nxënësve në shkolla, krahas sukseseve, të dhënat flasin për rritje të numrit të nxënësve të cilët në një moshë të caktuar braktisin shkollimin, ndërsa ka shumë pak raste të kthimit të tyre në shkollë. Arsytet e braktisjes lidhen për shkak të rrethit të panjohur dhe mosnjohjes së gjuhës, disa për shkak të ndërrimit të vendbanimit, martesave të hershme dhe kryerja e punëve të rënda për të siguruar jetesën për familje.

Shqetësues mbetet edhe fakti i fëmijëve të cilët merren me punë të rënda që pengojnë zhvillimin normal dhe rrezikojnë jetën e tyre. Këta fëmijë kryesisht merren me bujqësi për të ndihmuar familjen, tregti, punë në rrugë, grumbullim të mbeturinave. Kjo kategori e fëmijëve janë kryesisht të komunitetit RAE. Komunitet kanë bërë përpjekje të vazhdueshme që të zbatojnë kurrikulën në gjuhën rome, sigurimin e qasjes në arsim dhe luftimin e braktisjes së shkollimit.


Për të lehtësuar vijueshmërinë në shkollim, disa prej komunave kanë ofruar transportin e fëmijëve për në shkollë. Po ashtu, disa kanë ndarë edhe mjete (bursa) për shkollim për nxënës dhe studentë. Mjetet financiare janë ndarë edhe për nxënës dhe studentët që jetojnë në kushte të rënda, fëmijët pa njërin apo të dy prindërit, fëmijët e dëshmorëve, minoritetet, si dhe të kthyerit. Si shembull mund të merret Komuna e Pejës e cila ka ndarë 46 bursa për studentë. Po ashtu, janë ndërmarrë masa për regjistrimin e obliguar të fëmijëve në shkolla dhe përfshirjen e familjeve të tyre në skemën sociale. Në këtë drejtim, në Komunën e Vushtrrisë 12 familje kanë qenë përfituese të ndihmave sociale. Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve të komunave, janë mbajtur takime me prindër, janë organizuar fushata për rëndësinë e arsimimit, parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve, të drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësitë, fushata për rëndësinë e imunizimit të fëmijëve dhe inkuadrimin në sistemin shëndetësor. Përgjithësisht, komunat kanë bërë fushatë kundër dukurisë trafikimit me qenie njerëzore. Gjatë fushatave është vërejtur se në disa vendbanime, fshatra të thella kanë fare pak, apo aspak njohuri për trafikimin, sidomos tek komuniteti RAE. Komunitet kanë ndërmarrë veprime për të ofruar mësimin intensiv dhe atë plotësues.

Lidhur me sigurimin e qasjes në arsim dhe luftimin e braktisjes së shkollimit, komunat në përputhje me U.A. 7/2011 të MASHT-it kanë themeluar Ekipet për Parandalim dhe Reagim të Braktisjes. Këto Ekiye janë themeluar në komunat: Gjakovë, Ferizaj Malishevë, Istog, Klinë, Prizren, Fushë Kosovë, Hanit të Elezit, Mitrovicë, Shtërpçë, Gjilan, Shtime, Vushtrri, Skenderaj, Podujevë, Obiliq dhe Klinë. Përmes këtyre ekipeve janë ofruar informata të nevojshme mbi arsimin dhe luftimin e braktisjes së shkollimit tek nxënës, si dhe është organizuar dhe siguruar transporti falas për nxënës. Në vijim është paraqitur histogrami me të dhënat e braktisjes së shkollimit nga nxënës në komuna:



Histogrami Nr.35. Numri i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët

Nga figura e sipërme shihet se numri më i madh i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollimin është në komunat: Skenderajt, Ferizajt, Deçanit dhe Skenderajt. Në total, në këto komuna shkollimin kanë braktisur 967 nxënës, që paraqet një shifër mjaft shqetësuese. Komunat tjera nuk kanë raportuar për ndonjë shifër të braktisjes së shkollimit nga nxënësit në këto nivele të shkollimit. Sa i përket braktisjes së shkollimit në nivelin e mesëm të lartë, është paraqitur histogrami në vijim:



Histogrami Nr.36. Numri i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollimin fillor dhe të mesëm të lartë

Pra, vërejmë se braktisja e shkollimit të mesëm të lartë është mjaft e shprehur në komuna. Edhe pse ky nivel i shkollimit nuk është i obligueshëm, shifrat janë mjaft shqetësuese. Në 14 komuna, shkollimin e kanë braktisur gjithsej 886 nxënës.

3.2.7. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, komunat janë përgjegjëse të aplikojnë masa dhe parandalojnë çfarëdo forme të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj grupeve të grupeve të lëndueshme, ashtu siç parashihet me Ligjin Kundër Diskriminimit. Sipas të dhënave, komunat në vazhdimësi ofrojnë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët, duke respektuar rregullat standarde për ofrimin e qasjes së barabartë në institucione dhe në shoqëri. Tani është ndërtuar një nivel i vetëdijes kolektive që trajton nevojat dhe kërkesat e personave me aftësi të kufizuara. Të gjitha komunat kanë siguruar pjerrina dhe dysheme të rrafshuara për personat me aftësi të

kufizuar, në objektet e administratës komunale. Duhet veçuar Komunën e Gjilanit e cila ka rregulluar ashensorë dhe parkingje që mundësojnë qasje për PAK. Po ashtu, në Komunën e Prishtinës janë rregulluar semaforët me sinjalizim akustik. Përveç kësaj, kjo komunë ka punësuar edhe përkthyesin e gjuhës së shenjave, derisa komunat e tjera sigurojnë atë në raste të veçanta. Duke marrë parasysh nevojat për integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shoqëri, në shumicën e shkollave në komuna, klasat janë kombinuar me nxënësit me nevoja të veçanta. Së këndejmi, në Komunën e Prishtinës, nxënësit me aftësi të kufizuara vijnë në mësimin në klasë të bashkangjitura, duke filluar nga kopshtet e fëmijëve e deri në arsimin e lartë. Gjithashtu, në këtë komunë funksionon Qendra Burimore e Arsimit ku vijnë në mësimin 157 nxënës. Disa nga komunat sigurojnë transport falas për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në komuna ofrohen shërbime shëndetësore edhe nëpër shtëpi për personat e palëvizshëm. Madje, personat me aftësi të kufizuara janë të pajisur me librezë që i'u njihet e drejta pa pagesë për shërbime shëndetësore dhe transport. Sipas të dhënave të komunave të cilat kanë raportuar për fëmijët me nevoja të veçanta, aktualisht mësimin e ndjekin 507 nxënës me nevoja të veçanta, prej të cilëve 111 femra dhe 165 meshkuj. Kurse, 231 nxënës me nevoja të veçanta nuk janë raportuar sipas gjinisë. Nuk janë të pakta edhe rastet e fëmijëve të cilët nuk vijnë në mësimin. Vetëm në Komunën e Vitisë 40 fëmijë me nevoja të veçanta nuk vijnë fare në mësimin. Raste të tilla mund të ketë edhe në komunat tjera, e që nuk janë të raportuara.

3.3. Aftësia për të përballur obligimet që dalin nga MSA


3.3.1. Kthimi dhe riintegrimi

Personat e riatdhesuar ndihmohen dhe mbështetën nga Programi i Riintegritit bazuar në Rregulloren QRK Nr. 20/2013 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegritit, i cila është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 06 shtator 2013 dhe legjislacionin relevant në fuqi. Politikat Qeveritare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar janë të përcaktuara në Strategjinë Nacionale për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Planin e Veprimit, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 11 tetor 2013. Në Strategjinë e Riintegritit janë adresuar të gjitha sfidat e identifikuara gjatë procesit të Riintegritit të Personave të Riatdhesuar.

Sipas të dhënave, gjatë periudhës janar-dhjetor 2013 nga pikat kufitare tokësore dhe ajrore janë kthyer 5115 persona të riatdhesuar. Në të njëjtën periudhë janë parashtruar 1869 kërkesa nga personat e riatdhesuar për ndihmë dhe mbështetje nga Programi i Riintegritit.

Për shqyrtimin e kërkesave të personave të riatdhesuar që kanë aplikuar për përfitim nga Programi i Departamentit për Riintegrim, organet vendimmarrëse, përfshirë Bordin Ekzekutiv, Komisionin Qendror për Riintegrim dhe Komisionet Komunale për Riintegrim, kanë shqyrtuar gjithsej 1869 kërkesa për përfitim nga Programi për Riintegrim, dhe kanë marrë këto vendime:


- Janë aprovuar 1123 kërkesa (familjarë/individuale) të cilat kanë qenë të kompletuara dhe i kanë plotësuar kriteret për përfitim nga Programi i Departamentit për Riintegrim,
- Janë refuzuar 476 kërkesa (familjarë/individuale) që nuk i kanë plotësuar kriteret për përfitim të përcaktuara me legjislacionin në fuqi,
- Për verifikim dhe plotësim të dokumentacionit janë referuar 270 kërkesa.



Histogrami Nr.37. Numri i kërkesave të shqyrtuara, aprovuara, refuzuar dhe në proces për përfitim nga Programi për Riatdhesim gjatë vitit 2013.

Komisioni për Ankesa në nivel qendror ka mbajtur 2 takime ku janë shqyrtuar 13 ankesa, ku 4 prej tyre janë rishqyrtuar në Komisionin Qendror për Riintegrim, ndërsa 9 prej tyre janë refuzuar nga Komisioni për Ankesa.

Në total janë asistuar **2635** persona përfitues në skemat e ndryshme të Programit për Riintegrim. Prej tyre **1305** persona përfitues të skemave të Programit për Riintegrim janë bartur nga vitet paraprake në vitin 2013, ndërsa **1330** persona janë persona që përherë të parë (të ri) janë përfitues të skemave të ndryshme të Programit për Riintegrim në vitin 2013 .



Histogrami Nr.38. Numri i personave të kthyer përfitues nga Programi për Riatdhesim gjatë vitit 2013, sipas përkatësisë etnike

Nga histogrami I mësipërm, shohim se sipas nacionalitetit përfitues nga skema e programit për riintegrim janë 1224 ose 47 % shqiptar, 433 ose 16 % romë, 185 ose 7 % ashkali, 136 ose 5.2 % egjiptas, 54 ose 2 % boshnjak, 38 ose 1% goran, 282 ose 11% serbë, 21 ose 0.8% turq, kurse për 262 ose 10% mungojnë të dhënat e nacionaliteteve.⁸

Sa i përket strehimit, dymbëdhjet komuna kanë objekte të strehimit (Prizreni, Vitia, Vushtrria, Deçani, Ferizaj, Gjiçani, Peja, Mitrovica, Malisheve, Shtërpca, Obiliqi si dhe në pjesën Veriore të Mitrovicës). Ndryshe nga to, 14 komuna nuk kanë strehimore, siç janë: Parteshi, Klina, Kaçaniku,

⁸ DRPR, MPB: "Raport për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, janar-dhjetor 2013", Prishtinë, 2014.

Juniku, Istogu, Hani i Elezit, Graçanica, Fushë-Kosova, Rahoveci, Gllogoci, Prishtina, Shtimja, Suhareka, Peja, Novobërda, Mamusha dhe Lipjani. Komunat e tjera çështjen e strehimit e kanë rregulluar me ndërtimin e shtëpive, ndarjen e parcelave për ndërtim të shtëpive, financimeve nga donatorët, ndarjen e banesave sociale dhe përmes pagesës së qirasë.

Lidhur me asistencën afatshkurtër për personat e riatdhesuar, janë ofruar këto shërbime: Është siguruar banimi me qera për 148 familje; pako ushqimore për 1231 persona; barëra për 29 persona dhe pako dimërore për 276 persona.

Shërbimeve të ofruara për periudhë më afatgjatë janë këto: 9 shtëpi të rinovuara; 44 rindërtime/ndërtime të shtëpive; 22 orendi shtëpiake; 92 personave u janë ofruar kurse dhe mësim plotësues; 110 personave u janë ofruar trajnime për punësim; 17 persona janë punësuar në kompani të ndryshme; 1066 nxënës të riatdhesuar janë sistemuar në sistemin arsimor; Janë mbështetur 268 plan-biznese dhe 86 persona janë përfshirë në skemën sociale⁹.

Sa i përket decentralizimit të fondit për ri-integrim, komunat ende nuk menaxhojnë me këtë fond, por vetëm parashtrojnë kërkesat në organet vendimmarrëse për riintegrim në nivelin qendror. Zbatimi i procedurave për aplikim në këtë fond, në disa komuna ka pasur vështirësi dhe probleme, përdërisa në të tjerat ato janë zbatuar lehtësisht.


Sipas nenit 6 të Rregullores nr.10/2012 për Menaxhimin e Programit, Organet kompetente, Procedurat dhe kriteret e përfitimit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, komunat duhet të themelojnë Komisionin Komunal për Riintegrim përgjegjës për vendosjen e kërkesave të të kthyerve. Ky Komision është themeluar 25 komuna, kurse në 9 komuna ende nuk është themeluar, si është: Peja, Juniku, Suhareka, Ranillugu, Klllokoti, Mamusha, Skenderaj, Rahoveci dhe Parteshi.

3.3.2. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, komunat obligohen që në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tyre dhe në bazë të nevojave të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në territorin e tyre, të krijojnë mekanizma administrativ, përkatësisht Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, qëllimi i të cilave është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komuniteteve. Sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, ZKK duhet të jetë pjesë integrale e administratës komunale dhe të parashihet me Statutin e Komunës.

Aktualisht, mënyra e organizimit dhe të njohjes së këtyre zyrave me Statutet e Komunave qëndron si në vijim:

⁹ Po aty



Histogrami nr. 39. Mënyra e organizimit dhe rregullimit juridik të ZKK-ve në komuna

Ashtu siç shihet nga histogrami i mësipërm, ZKK nuk është themeluar në një komunë (Junik). Krahas saj, në 4 komuna nuk është rregulluar emërtimi i ZKK-së sipas Rregullores në fuqi (Gjakovë, Klinë, Lipjan dhe Dragash), në 2 komuna (Pejë dhe Klinë) është përcaktuar gabimisht përgjegjësia e raportimit dhe në 1 komunë nuk janë paraparë të gjitha pozitat e zyrtarëve që duhet të jenë (Deçan).

3.4. Bujqësia

Në sektorin e bujqësisë, shumica e komunave kanë hartuar Programin Zhvillimor konform Master-Planit 2010-2013 për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë dhe Strategjisë Komunale për Zhvillim. Ky program është hartuar në 30 komuna, duke përfshirë komunat: Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Fushë-Kosovë, Deçan, Lipjan, Gllogoc, Shtërpçë, Junik, Prizren, Kamenicë, Kaçanik, Istog, Ranillug, Hani i Elezit, Viti, Shtime, Mamushë, Novobërdë, Skenderaj, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Dragash, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë, Graçanicë dhe Vushtrri. Ndërsa, ky Program nuk është hartuar në: Ferizaj, Klinë, Kllokot dhe Partesh.

Në bazë të planifikimeve dhe mundësive buxhetore, komunat kanë ndarë mjete financiare për mbështetjen dhe modernizimin e sektorit privat të bujqësisë. Një mbështetje të veçantë për sektorin e bujqësisë kanë dhënë organizatat ndërkombëtare dhe ato joqeveritare. Këto mbështetje kanë dhënë efektin e tyre në përmirësimin e efikasitetit në prodhim dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Grantet janë dhënë kryesisht për subvencionimin e fermerëve, në blegtori, bletari, bujqësi dhe pemtari. Po ashtu, janë ndarë mjete për subvencione për marketing, përmirësimin e teknologjisë me qëllim të rritjes së efikasitetit në prodhim, përmirësimin e infrastrukturës në zonat rurale, duke investuar në: rrugë, rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, transportin në zonat rurale, përmirësimin e qasjes në tokat bujqësore, përmirësimin e sistemit të ujitjes etj. Në këtë drejtim, Grupet Lokale të Veprimit me ndikim në zonat rurale kanë luajtur rol të rëndësishëm në realizimin e këtyre projekteve. Megjithatë, një pjesë e komunave nuk i kanë të themeluar GLV-të. Me qëllim të përkrahjes së këtij sektori, në komuna janë themeluar shërbimet këshilluese për bujqësi.

* Në Komunën e Gjakovës janë funksionale 5 Qendra për dhënien e këshillave për bujqësi; Në Komunën e Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Kamenicës, Dragashit janë themeluar dhe janë funksionale Qendrat për Këshilla Rurale dhe Këshilla për Biznese; Në Ferizaj është bërë formimi i grupeve liderë të fermerëve për dhënien e këshillave dhe informata të ndryshme; Komuna e Kaçanikut e ka Zyrën për trajnime e cila është e pajisur dhe funksionale; Komuna e Istogut ka 1 këshilltar për këshilla të fermerëve; Komuna e Ranillugut e ka Qendrën për Këshilla Rurale; Në Komunën e Hani të Elezit, Vitisë, Graçanicës, Klinës, Fushë Kosovës, Deçanit dhe Kllokotit nuk janë formuar ende qendrat këshillimore; Në Gllogoc, funksionon Zyra dhe Qendra e Biznesit one-stop-shop që merret me këshilla për

Sipas nenit 7.2 të Ligjit Nr. 04/L-074 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural “secila komunë duhet të ketë nga një pikë kontaktuese e cila shërben si qendër informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural për marrjen dhe përcjelljen e këshillave dhe informatave për fermer dhe komunitetin”. Në bazë të dhënave, 22 komuna kanë themeluar Qendrat për Këshilla Rurale, siç është rasti në komunat: Gjakovë, Gjiilan, Malishevë, Lipjan, Kamenicë, Dragashit, Ferizaj, Kaçanik, Istog, Ranillug, Glogoc, Junik, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë, Shtime, Vushtri, Skenderaj, Podujevë, Pejë, Prishtinë, Novobërdë. Krahas tyre, 16 komuna ende nuk i kanë themeluar këto qendra si në: Prizren, Mamushë, Obiliq, Hani i Elezit, Vitia, Graçanica, Klinë, Suharekë, Fushë Kosovë, Deçan, Klokot, Partesh.

3.5. Kontrolli financiar

Në fushën e auditimit të brendshëm, komunat obligohen që sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm të themelojnë Njësine për Auditimin e Brendshëm. Sipas të dhënave, Njësia e Auditimit është e themeluar dhe funksionon në 30 komuna, ndërsa nuk është themeluar në komunat: Hani i Elezit, Mamushë, Klokot dhe Partesh. Për dallim nga njësia e auditimit, komunat obligohen që sipas nenit 6.2 të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm të themelojnë Komitetin e Auditimit të Brendshëm, i cili është një organ i pavarur këshilldhënës për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik dhe mbështetës për auditorët e brendshëm. Këtë Komitet e kanë themeluar 22 komuna, ndërsa nuk është themeluar në: Gjakovë, Lipjan, Istog, Shtërpçë, Hani i Elezit, Klinë, Shtërpçë, Klokot, Mamushë, Suharekë, Partesh dhe Obiliq. Sa i përket kapaciteteve komunale, numri i përgjithshëm i auditorëve në komuna është 60. Prej tyre, 48 janë të certifikuar ndërsa 12 janë në proces të certifikimit. Për më saktë, të dhënat për nivelin e auditorëve nëpër komuna tregojnë se: në Komunën e Gjakovës është 1 auditor i brendshëm i cili është në proces të certifikimit; Në Gjiilan janë 4 auditor në proces të certifikimit; Në Komunën e Lipjanit janë 3 auditor të brendshëm, ndërsa vetëm njëri është i licencuar nga CIPF; Në Komunën e Prizrenit, Istogut dhe Ranillugut është vetëm nga 1 auditor i brendshëm; Në Komunën e Kamenicës janë 2 auditorë, prej tyre njëri i certifikuar; Në Komunën e Ferizajt janë 3 auditorë të brendshëm, 2 nga ta në proces të certifikimit; Komuna e Klinës, Glogocit, Junikut, Shtimes, Shtërpçë, Malishevës, Kaçanikut, Dragashit, Obiliqit, Novobërdës dhe Skenderajt kanë nga 1 auditor të certifikuar; Në Fushë-Kosovë, Deçan, Vushtri dhe Rahovec janë nga 2 auditorë. Në Mitrovicë dhe ZAMV janë nga 3 auditorë të licencuar; Në Komunën e Graçanices janë 4 auditorë, prej tyre 1 është në procesi të certifikimit; Në Komunën e Vitisë janë 2 auditorë, 1 i certifikuar dhe 1 në proces; Në Komunën e Podujevës janë 6 auditor të certifikuar; Komuna e Pejës dhe Prishtinës kanë nga 3 auditorë të certifikuar; Komuna e Suharekës e ka 1 auditor në proces të certifikimit. Krahas tyre, komunat të cilat nuk kanë auditor të brendshëm janë: Hani i Elezit, Mamusha, Klokoti, dhe Parteshi.

Lidhur me raportet e auditimit, komunat kanë pranuar rekomandime nga auditorët e brendshëm, të cilat janë diskutuar edhe në mbledhjet e kuvendeve të komunave¹⁰.

fermerët dhe bizneset; Në Komunën e Junikut ekzistojnë qendrat për këshilla rurale; Në Komunën e Rahovecit në kuadër të Drejtorisë për BPZHR është zyrtari për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve për fermer; Në Komunën e Shtërpçës janë të sistemuara këshilldhënësit në kuadër të departamentit për zhvillim rural; Në Mitrovicë janë zyrtarët e trajnuar të cilët japin këshilla për fermerë dhe OJQ-të për të aplikuar në grante të ndryshme; Në Komunën e Shtimes është themeluar një qendër këshilluese; Në Komunën e Vushtrisë është caktuar zyrtari për shërbime këshillimore si dhe infrastrukturën e nevojshme për organizimin e tyre; Në Komunën e Skenderajt janë formuar grupet këshilluese për sektorët e ndryshme të bujqësisë; Në Pejë, në kuadër të drejtorisë për bujqësi ekziston shërbimi këshillimor i cili jep këshilla për fermer; Në Prishtinë, qendrat për këshilla rurale nuk shquhen për një funksionalitet të mirë; Komuna e Novobërdës ka një Qendër për Këshilla Rurale. Komunat e tjera nuk kanë ofruar përgjigje lidhur me këtë çështje.

¹⁰ Në Komunën e Gjakovës, gjatë vitit 2013, nga Auditori i Brendshëm janë dhënë 2 rekomandime; Në Gjiilan 41 rekomandime; Malishevë 7 rekomandime; Lipjan 26 rekomandime; Prizren 15 rekomandime; Kamenicë 15 rekomandime; Në Ferizaj janë dhënë 27 rekomandime; Kaçanik 33 rekomandime; Istog 16 rekomandime; Ranillug 2 rekomandime; në komunën e Dragashit janë dhënë 26 rekomandime; Në Komunën e Klinës dhe Fushë Kosovës auditori ka dhënë gjithsej nga 20 rekomandime; Deçan 47 rekomandime; Glogoc 41 rekomandime; Në Junik numri i rekomandimeve të dhëna është 52; Në Rahovec janë dhënë 75 rekomandime; Në Shtërpçë 20 rekomandime; Në Komunën e Mitrovicës është 39; Graçanicë është 15; Në ZAMV dhe Viti janë dhënë nga 5 rekomandime; Në Komunën e Shtimes janë dhënë 3 rekomandime; Në Vushtri janë dhënë 13 rekomandime; Skenderaj janë dhënë 29 rekomandime; Podujevë 12 rekomandime; Obiliq është dhënë 1 rekomandim; Pejë janë dhënë 47 rekomandime; Prishtinë 10 rekomandime.

3.6. Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik

Punësimi, politikat sociale dhe politikat e shëndetit publik janë disa nga fushat për të cilat komunat kanë ndërmarrë masa për të ngritur mirëqenien e përgjithshme. Komunat kanë vënë prioritetet që komunitetet të jenë pjesë e politikave të punësimit. Disa komuna kanë hartuar strategji komunale për të përfshirë komunitetet në politikat e punësimit dhe ato sociale. 16 komuna kanë të hartuara strategji të punësimit, duke përfshirë komunat: Gjakovë, Gjiçani, Hani i Elezit, Dragashi, Lipjani, Ferizaj, Klinë, Deçani, Drenas, Juniku, Vitinë, Shtimes, Podujevë, Obiliq, Pejë, Novobërdë. Për dallim nga to, komunat të cilat nuk e posedojnë strategji punësimi janë: Prizreni, Kamenica, Kaçaniku, Fushë Kosova, Prishtina, ZAMV-ja, Ranillugu, Istogu, Klokoti, Rahoveci, Shtërpçës, Graçanicës, Mamushës, Skenderajt, Vushtrri, Parteshit, Suharekës, Mitrovicës, Zveçanit, Leposaviçit, Zubin Potokut.

Ekziston një bashkëpunim i mirë me OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të shumta të mirëqenies sociale. Numri i përgjithshëm i OJQ-ve të përfshira në komuna lidhur me ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale është 22, ndërkaj 16 komuna nuk e kanë të përfshirë OJQ-të në ofrimin e këtyre shërbimeve. Komunat të cilat kanë përfshirë OJQ-të vendore dhe të huaja janë: Gjakova, Gjiçani, Ferizaj, Malisheva, Lipjani, Prizreni, Kamenica, Kaçaniku, Istogut, Ranillugut, Klokoti, Deçan, Drenas, Rahovec, Mitrovicë, Shtime, Vushtrri, Podujevë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Novobërdë. OJQ-të kanë financuar projekte lidhur me përkujdesjen shëndetësore, ndërtimin e shtëpive, ofrimin e pakove ushqimore, strehimin familjar, promovimin e barazisë gjinore, përkujdesje shëndetësore etj.

Po ashtu, komunat kanë shtuar kujdesin e veçantë ndaj kategorive të rrezikuara siç janë: fëmijët, shtatzënat, të sëmurët kronik, shtresat me asistencë sociale. Mbështetja është realizuar përmes mjeteve financiare në fushën e shëndetësisë dhe strehimit, si dhe në fushën e shërbimeve dhe asistencës sociale. Në 22 komuna janë themeluar ekpjet mobile të cilat ofrojnë qasje pro-aktive në vaksinim, si është rasti me komunt: Gjakovë, Gjiçan, Viti, Shtime, Vushtrri, Podujevë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Malishevë, Lipjan, Prizren, Kamenicë, Ferizaj, Istog, Hani i Elezit, Deçan, Drenas, Rahovec, Shtërpca, Mitrovicë dhe Klokoti.

Në kuadër të aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve sociale në komuna, ka filluar mbyllja e një pjese të Qendrave Kolektive në Mitrovicë, ku 18 familje janë vendosur në banesa. Këtyre kategorive u ofrohet shërbimi me një përkujdesje të veçantë në shërbimet shëndetësore, edukim, preventim, mjekim primar dhe diagnostifikimi kryesisht në QKMF dhe në QMF-të e tjera¹¹. Po ashtu, ekziston një bashkëpunim i ngushtë mes komunave dhe Qendrave për Punë Sociale, të cilat kanë realizuar vizita të rregullta tek grupet e cënueshme dhe tek familjet të cilët marrin ndihma sociale. Numri i përgjithshëm i vizitave të realizuara nga Qendrat për Punë Sociale grupeve të cënuara në komuna është 1387 vizita.

Sipas të dhënave numri i personave të identifikuar që kanë nevojë për kujdes social është mbi 31412. Në total, numri i përgjithshëm i ndihmës së ofruar grupeve të cënuara (financiare, në të mira) është 14416. Shifrat për numrin e personave që kanë nevojë për përkujdesje sociale janë të mëdha, andaj komunat duhet të vazhdojnë me zhvillimin e politikave të punësimit, përmirësimin e mirëqenies sociale dhe krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik lokal. Për shembull, vetëm në Komunën e Gjakovës janë identifikuar 1232 familje me 5283 persona të cilët kanë nevojë për përkujdesje sociale. Krahës saj, në Komunën e Malishevës janë 839 familje me nevoja, Lipjan 135 fëmijë me nevoja të veçanta të cilëve u ofrohet përkrahje materiale, në Komunën e Istogut janë 687 familje me 2840 anëtarë që përfitojnë asistencë sociale, ndërsa në Glogoc numri i familjeve që përfitojnë asistencë sociale është 1491.

¹¹ Në komunën e Gjakovës, Gjiçanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Ferizajt, Kaçanikut, Istogut, Klokotit, Klinës, Glogocit, Deçan, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë, Hani i Elezit, Vitinë, Shtimes, Vushtrrisë, Podujevës, Obiliqit, Pejë, Prishtinës, Novobërdës, Klokotit dhe Fushë Kosovës, të gjitha komunitetet pakicë kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore; Komuna e Kamenicës, Graçanicës dhe Dragashit nuk kanë ofruar përgjigje; Në ZMAV ka mundësi për të dalë në ndihmë personave në nevojë dhe personave të riatdhesuar për sigurimin e kujdesit shëndetësor parësor, sepse në këtë moment atë nuk e lejon situata në terren

TABELA Nr. 15. TË DHËNAT E TË PUNËSUARËVE NË ADMINISTRATË NË KOMUNA, DHJETOR 2013

KOMUNAT	Nr. i përgjith. i të punësuarëve	Struktura etnike										Struktura gjinore		Përqindja e shërbuesve civil sipas strukture etnike dhe gjinore													
		SH	S	B	T	G	A	E	R	të tj.	të p.p.	m	f	Sh %	S%	B%	T%	G%	A%	E%	R%	Të tjerë	Të P.P	M	F		
1.DEQAN	133	130	1	2	0	0	0	0	0	0	0	106	27	97.74	0.75	1.50	0	0	0	0	0	0	0	79.70	20.3		
2.DRAGASH	133	95	0	38	0	0	0	0	0	0	0	120	13	71.43	0.00	28.57	0	0	0	0	0	0	0	90.23	9.8		
3.FERIZAJ	280	262	1	0	1	2	11	0	3	0	0	204	76	93.57	0.36	0	0.36	0.71	3.93	0	1.07	0	0	72.86	27.1		
4.FUSHË-KOSOVË	139	117	17	0	0	0	3	0	2	0	0	89	50	84.17	12.23	0	0	0	2.16	0	1.44	0	0	64.03	36.0		
5.GLOGOVCI	155	155	0	0	0	0	0	0	0	0	0	43	112	100	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	27.74	72.3		
6.GJAKOVË	305	299	0	1	0	0	4	1	0	0	0	226	79	98.03	0.00	0.33	0	0	1.31	0.33	0	0	0	74.10	26		
7.GJILAN	338	304	30	0	3	0	0	0	1	0	0	258	80	89.94	8.88	0	0.89	0	0	0	0.30	0	0	76.33	23.7		
8.ISTOG	159	142	2	11	0	0	0	4	0	0	0	115	44	89.31	1.26	6.92	0	0	0	2.52	0	0	0	72.33	27.7		
9. KAÇANIK	128	128	0	0	0	0	0	0	0	0	0	106	22	100	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	82.81	17.2		
10. KAMENICË	209	176	31	0	0	0	0	0	2	0	0	161	48	84.21	14.83	0	0	0	0	0	0.96	0	0	77.03	23		
11. KLINË	136	131	3	0	0	0	0	0	0	2	0	108	28	96.32	2.21	0	0	0	0	0	0	1.47	0	79.41	20.6		
12.LYPJAN	185	169	12	1	1	0	2	0	0	0	0	139	46	91.35	6.49	0.54	0.54	0	1.08	0	0	0	0	75.14	24.9		
13. MALISHEVË	155	155	0	0	0	0	0	0	0	0	0	130	25	100	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	83.87	16.13		
14. MITROVICË J.	311	293	2	10	4	0	1	0	1	0	0	116	195	94.21	0.64	3.22	1.29	0	0.32	0	0.32	0	0	37.30	62.7		
15. MITROVICA V.	56	9	35	7	4	1	0	0	0	0	0	28	28	16.07	62.50	12.5	7.14	1.79	0	0	0	0	0	50.00	50		
16. NOVOBËRDË	68	41	27	0	0	0	0	0	0	0	0	56	12	60.29	39.71	0	0	0	0	0	0	0	0	82.35	17.6		
17. OBILIQ	83	69	12	1	0	0	0	0	1	0	0	50	33	83.13	14.46	1.20	0	0	0	0	1.20	0	0	60.24	39.8		
18. PEJË	332	316	4	9	0	0	0	2	1	0	0	228	104	95.18	1.20	2.71	0	0	0	0.60	0.30	0	0	68.67	31.33		
19.PODUJEVË	266	262	2	0	0	0	2	0	0	0	0	214	52	98.50	0.75	0	0	0	0.75	0	0	0	0	80.45	19.5		
20.PRISHTINË	688	649	30	4	4	0	1	0	0	0	0	453	235	94.33	4.36	0.58	0.58	0	0.15	0	0	0	0	65.84	34.2		
21.PRIZREN	358	297	2	30	25	0	1	1	2	0	0	265	93	82.96	0.56	8.38	7.0	0	0.28	0.28	0.56	0	0	74.02	26.0		
22.RAHOVEC	159	145	14	0	0	0	0	0	0	0	0	139	20	91.19	8.81	0	0	0	0	0	0	0	0	87.42	12.6		
23.SKËNDERAJ	195	186	9	0	0	0	0	0	0	0	0	157	38	95.38	4.62	0	0	0	0	0	0	0	0	80.51	19.5		
24.SUHAREKË	155	152	0	0	0	0	2	0	0	1	0	125	30	98.06	0.00	0	0	0	1.29	0	0	0.65	0	80.65	19.4		
25.SHTERPCË	95	33	62	0	0	0	0	0	0	0	0	71	24	34.74	65.26	0	0	0	0	0	0	0	0	74.74	25.3		
26.SHTIME	94	92	0	1	0	0	1	0	0	0	0	66	28	97.87	0.00	1.06	0	0	1.06	0	0	0	0	70.21	29.8		
27.VITI	162	158	4	0	0	0	0	0	0	0	0	140	22	97.53	2.47	0	0	0	0	0	0	0	0	86.42	13.6		
28.VUSHTRRI	213	198	11	0	3	0	1	0	0	0	0	164	49	92.96	5.16	0	1.41	0	0.47	0	0	0	0	77.00	23.0		
29. HANI I ELEZIT	52	51	0	1	0	0	0	0	0	0	0	48	4	98.08	0.00	1.92	0	0	0	0	0	0	0	92.31	7.69		
30. MAMUSHË	42	7	0	1	32	0	0	0	2	0	0	33	9	16.67	0.00	2.38	76.2	0	0	0	4.76	0	0	78.57	21.43		
31. JUNIKU	55	55	0	0	0	0	0	0	0	0	0	47	8	100	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	85.45	14.5		
32. KLOKOT	46	16	30	0	0	0	0	0	0	0	0	34	12	34.78	65.22	0	0	0	0	0	0	0	0	73.91	26.1		

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

33. PARTESH	62	4	58	0	0	0	0	0	0	0	0	52	10	6.45	93.55	0	0	0	0	0	0	0	0	83.87	16.1
34. RANILLUGE	56	6	50	0	0	0	0	0	0	0	0	42	14	10.71	89.29	0	0	0	0	0	0	0	0	75.00	25
35. GRAQANICE	61	5	54	0	0	1	0	0	1	0	0	38	23	8.20	88.52	0	0	1.64	0	0	1.64	0	0	62.30	37.7
36. LEPOSAVIQ	127	8	116	3	0	0	0	0	0	0	0	79	48	6.30	91.34	2.36	0	0	0	0	0	0	0	62.20	37.8
37. ZUBIN POTOK	226	16	210								0	118	108	7.08	92.92	0	0	0	0	0	0	0	0	52.21	47.8
38. ZVEQAN	57	4	53								0	29	28	7.02	92.98	0	0	0	0	0	0	0	0	50.88	49.1
TOTALI	6474	5335	882	120	77	4	29	8	16	3	0	4597	1877	82.41	13.62	1.854	1.19	0.062	0.45	0.124	0.25	0.05	0	71.01	28.99

Shënim:

- Në fushën e administratës, të dhënat për komunat, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan, janë marrë nga Divizioni i Sistemit të Pagave MAP – DASHC.
- Në fushën e administratës, të dhënat për Komunën e Gllogovcit janë marrë nga Raporti janar-mars, 2013.
- Në fushën e administratës, të dhënat për Komunën e Parteshit janë marrë nga Raporti mbi ndarjen në kategori të shc dhjetor 2013.

Shkurtesat e përdorura:


- sh=shqiptar, s=serb, b=boshnjak, t=turq, g=goran, a=ashkalinjë, e=egjyptianë, r=romë, të tj= të tjerë, m=meshkuj, f=femra
- Të p.p. (struktura e pa percaktuar e sherbyesve civil)

3.7. Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Çështjet mjedisore dhe klimatike janë fusha prioritare për vendin. Për trajtimin e këtyre çështjeve, në nivelin lokal rrjedhin disa obligime të cilat përfshijnë, së pari, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin e mjedisit, mbajtjen e trajnimeve për zbatimin e legjislacionit mjedisor, trajnimet për inspektorët komunal të ambientit, trajnimet për zyrtarët komunal në trajtimin e vendbanimeve jo formale, trajnimet për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane, zbatimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.

Hartimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave janë dy dokumente të cilat parashihen me Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave, të cilat për qëllim kanë mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Niveli lokal dhe qendror kanë bashkëpunuar ngushtë në sektorin e mjedisit, duke zhvilluar projekte të ndryshme. Lidhur me aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në nivelin lokal, komunat kanë organizuar trajnime për zyrtarët komunal për zbatimin e legjislacionit mjedisor. Në vijim janë paraqitur të dhënat për numrin e trajnimeve të mbajtura në komuna:



Histogrami Nr.40. Numri i trajnimeve për zyrtarët komunal për zbatimin e legjislacionit mjedisor

Nga të dhënat shihet se gjithsej janë mbajtur 53 trajnime për zyrtarët komunal. Krahas komunave të paraqitura në histogram, Komuna e Shtërpçës, Fushë-Kosovës, Prizrenit, Prishtinës, Parteshit, Novobërdës, Graçanicës dhe Suharekës nuk kanë deklaruar për numrin e trajnimeve në këtë fushë. Ndërsa, përgjigje të përgjithshme kanë dhënë komunat: Deçan, Kamenicë dhe Hani i Elezit.

Përveç trajnimeve në fushën e zbatimit të legjislacionit mjedisor, janë mbajtur edhe trajnime me inspektorët komunal të ambientit në komunat: Gjakovë, Pejë, Viti, Mamushë, Vushtrri, Skenderaj, Prishtinë, Malishevë, Prizren, Klinë, Deçan, Glogoc, Podujevë, Junik, Rahovec, Obiliq, Prishtinë dhe Kamenicë. Komunat e tjera ose nuk kanë dhënë përgjigje ose kanë ofruar shënime të përgjithësuar. Trajnime të tjera janë mbajtur për vendbanimet jo-formale, për procesin e hartimit të Planeve dhe Rregulloreve Urbane, si dhe Implementimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor.

Sa u përket inspektorëve komunal të ambientit, të dhënat janë këto: Komuna e Gjakovës dhe Prishtinës kanë nga 3 inspektorë komunal të ambientit; Komuna e Malishevës, Prizrenit, Kaçanikut, Glogocit, Ranillugut, Shtimes, Podujevës, Dragashit, Junik, Klinës, Rahovecit kanë nga 1 inspektor; Komuna e Gjilanit, Lipjanit, Hani të Elezit, Skenderajt, Mamushës, Fushë-

Kosovës, Graçanicës, Mitrovicës, Shtërpçës, ZAMV dhe Kllokoti nuk kanë ofruar të dhëna; Në Komunën e Kamenicës Vitisë, Vushtrisë, Pejës, Obiliqit dhe Deçanit janë nga 2 inspektorë të ambientit, kurse në Komunën e Ferizajt, Novobërdës dhe Istogut nuk ka asnjë inspektor.

Në komuna është i pranishëm problemi i vendbanimeve joformale. Një pjesë e tyre i kanë përfshirë këto vendbanime në planet zhvillimore komunale¹². Kurse, ndër shkaktarët kryesor të ndotjes së ambientit është vlerësuar të jenë gurëthyesit, të cilët në të shumtën e rasteve nuk kanë respektuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Kështu që, disa komuna kanë bërë edhe studimin e arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura.¹³

Për të avancuar në fushën e mjedisit, komunat kanë bashkëpunuar ngushtë me ministrinë përgjegjëse, organizatat e tjera vendore dhe ato ndërkombëtare. Disa nga aktivitetet e përbashkëta mjedisore mes komunave dhe ministrive kanë qenë:

- Realizimi i projektit për Studimin e Fizibilitetit për ujëra të zeza në Komunën e Gjilanit dhe impianti i pastrimit të ujërave nga kompania (ËYG), donacion nga Komisioni Evropian.
- Vendosja e kontejnerëve në Komunën e Malishevës dhe përfshirja e 8 fshatrave në shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Gjithashtu, janë vendosur panot me mbishkrimin “Mos hedhë mbeturina”.
- Identifikimi i deponimeve ilegale nga AMMK në Komunën e Lipjanit.
- Projekti “Të pastrojmë Kosovën” në Komunën e Ferizajt dhe Hanit të Elezit, mbështetur nga MMPH.
- Monitorimi i rregullt i ndotjes së ajrit nga IHMK në Komunën e Hanit të Elezit, identifikimi i deponimeve ilegale.
- Pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat e azbestit.
- Projekti i për “Inventarizimin e peizazheve natyrore”, mbështetur nga Këshilli i Evropës, MMPH, MBPZHR dhe Komuna e Klinës.
- Caktimi i lokacioneve për deponitë e mbeturinave në komunën e Glllogocit.

¹² Në Komunën e Gjakovës janë 5 vendbanime jo formale. Komuna e Malishevës dhe Ranillugut nuk kanë vendbanime jo formale; Në Komunën e Lipjanit janë 7 vendbanime jo formale; Komuna e Prizrenit, Hanit të Elezit, Dragashit, Fushë e Kosova, Mitrovica, ZAMV dhe Kllokoti nuk kanë ofruar përgjigje; Komuna e Kamenicës është përgjigjur se vendbanimet joformale janë të përfshira në PZHK; Në Komunën e Ferizajt janë 3 vendbanime jo formale; Në Komunën e Kaçanikut vendbanimet joformale janë të përfshira në planet hapësinore komunale; Në Komunën e Istogut janë dy vendbanime jo-formale të përfshira në Planin komunal hapësinor; Në Komunën e Klinës janë 7 vendbanime joformale që mbeten të përfshihen në PRZH; Në Deçan vendbanimet joformale janë përfshirë në Planin Zhvillimor Hapësinor Komunal; në Glllogoc janë 3 vendbanime joformale: Poklek, Lagja Feronikeli dhe Komoran (Lagja e Reo); Në Junik janë 3 vendbanime joformale të përfshira në planet hapësinore komunale; Një vendbanim jo formal është në Komunën e Rahovecit; Në Komunën e Shtërpçës nuk është trajtuar asnjë vendbanim joformal; Në Komunën e Vitisë në planet hapësinore komunale janë të përfshira 3 vendbanime jo formale; Në Komunën e Shtimes janë 3 vendbanime formale; Komuna e Mamushës është përgjigjur se nuk ka vendbanime joformale; Në Komunën e Vushtrisë disa vendbanime jo formale janë të përfshira në planet hapësinore komunale; Në Komunën e Skenderaj janë të evidentuara zyrtarisht dy vendbanime joformale: Runiku dhe Kopiliqi i ulët, të cilat janë të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal; Në Komunën e Podujevës vendbanim joformal është “Lagja e Kuvajtit”; Në Komunën e Obiliqit janë 5 vendbanime joformale; Në Komunën e Pejës të gjitha vendbanimet jo formale (“Zatra”, “Xh.Kada”, “7 Shtatori”, “Kristali” dhe “Asllan Çesma”) janë të përfshira në planet hapësinore komunale; Në Komunën e Prishtinës vendbanimet jo formale janë trajtuar përmes Planeve Rregullative; Në Komunën e Novobërdës vendbanimet jo formale janë të përfshira në PZHK.

¹³ Në Komunën e Gjakovës është kryer studimi për zonat e mbrojtura, ndërkaq është në proces punimi i PRRU-s “Shkugëza” si peizazh i mbrojtur; Në Komunën e Lipjanit, Zonat e Mbrojtura janë definuar në kuadër të PZHK-së; Në Komunën e Ferizajt me vendim të kuvendit të komunës nr.4603 të datës 17.09.2002 zona turistike prej 20 ha dhe bifurkacioni i lumit të Nerodimes si zonë e mbrojtur. Në Deçan është kryer studimi i arsyeshëm për zonat e mbrojtura, në Glllogoc është në proces, kurse Komuna e Junikut dhe Rahovecit nuk kanë zona të mbrojtura. Në Komunën e Shtërpçës, zonat e mbrojtura janë paraparë nga niveli qendror. Në Komunën e Vitisë janë bërë studime të arsyeshmërisë për zonat e mbrojtura në komunë dhe janë shpallur në PZHU dhe PZHK; Në Komunën e Shtimes nuk ka zona të mbrojtura në komunë, komuna e Vushtrisë është përgjigjur se nuk është bërë studimi i arsyeshmërisë; Në Komunën e Podujevës kanë disa zona natyrore dhe objekte që mund të shpallen si të mbrojtura; Komuna e Pejës ka bërë arsyeshmërisë për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna “Park Nacional”.

- Zhvillimi i aksionit për pastrimin e mbeturinave me 1 prill dhe 22 prill 2013 në Komunën e Glllogocit etj.

Aktivitetet të tjera kanë të bëjnë me hartimin e Planeve Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave. Komunitat të cilat nuk e kanë hartuar këtë Plan janë: Gjakova, Lipjani, Dragashi, Fushë-Kosova, Mamusha, Podujeva dhe Klllokoti. Në Komunën e Ferizajt është formuar komisioni i përbashkët në mes të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjes Regjionale “Pastërtia” për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Në Komunën e Glllogocit në bashkëpunim me GIZ-in gjerman ky Plan është në proces të hartimit, derisa Komuna e Kaçanikut, Deçanit, Graçanicës, Shtimes, Skenderajt dhe Hanit të Elezit nuk kanë ofruar përgjigje nëse e kanë të hartuar këtë Plan.

Komunitat kanë zhvilluar aktivitete për pyllëzimin e sipërfaqeve pyjore*, mirëpo ka edhe komuna të cilat nuk kanë ndërmarrë aktivitete në këtë aspekt. Në total, komunitat kanë pyllëzuar 17157 ha pyje. Krahas kësaj, janë bërë inspektime të rregullta nga inspektorët e pyjeve, ku janë shqiptuar dënime për dëmtuesit apo shfrytëzuesit ilegal të pyjeve. Në total komunitat kanë bërë 2033 inspektime, ndërsa kanë ushtruar 5.071 fletëparaqitje. Niveli i dëmeve të shkaktuara nga prerjet ilegale dhe nga zjarret është i ndryshëm në komuna. Dëmi më i madh është shkaktuar nga prerjet ilegale, ku vetëm në Komunën e Gjakovës janë paraqitur rreth 300 fletëparaqitje për kundërvajtje, ndërsa shumë vepra penale të prerjes së pyjeve janë në proces.

3.8. Bashkëpunimi ndërkomunal

Fusha e Bashkëpunimit Ndër-komunal në Republikën e Kosovës është e rregulluar me Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkomunal nr. 04/L-010, dt. 21.07.2011. Me anë të këtij Ligji është paraparë rregullimi i bashkëpunimit ndër-komunal dhe i bashkëpunimit të komunave të Republikës së Kosovës me komuna dhe institucione të tjera të qeverisjes lokale jashtë Kosovës. Tani është krijuar infrastruktura ligjore dhe mekanizmat për rregullimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkomunal në Kosovë. Përveç Ligjit janë miratuar edhe Rregullorja për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe Rregullorja për procedurat e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

Bashkëpunimi Ndërkomunal nënkupton Marrëveshjen në mes të dy apo më shumë komunave brenda dhe jashtë Kosovës. Bashkëpunimi ndërkomunal është pjesë thelbësore e reformës së vetëqeverisjes lokale, e cila jo vetëm që ka ndikim të madh në procesin e decentralizimit, por ka efekt shumë pozitiv në planifikimin dhe strategjitë për zhvillim ekonomik.

Fushat e fokusimit dhe të bashkëpunimit në mes të komunave kryesisht janë:

- Fusha e shërbimeve publike komunale dhe
- Fusha e zhvillimit ekonomik lokal.

* Në Komunën e Gjakovës, Agjencioni i Pyjeve ka bërë pyllëzimin e 25 ha; Në Malishevë janë pyllëzuar 30 ha; Në Komunën e Gjiçanit 20 ha; në Lipjan janë pyllëzuar 20 ha; Në Prizren 15 ha; Kamenicë 15 ha; Ferizaj 6 hektar me dru halor; Kaçanik 10 hektar sipërfaqe; Në Komunën e Hanit të Elezit 7 ha; Në Dragash 15 ha; Klinë 6 ha; Glllogoc 10 h; Junik 7 hektarë me 17,500 fidanë të llojit pishë e zezë dhe poje; Vitii 15 ha; Shtime 10 ha; Vushtrri 39.00 ha; Podujevë 70 ha pisha dhe fidanë të ndryshme; Në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 nuk ka pasur ri-pyllëzim; Në Komunën e Prishtinës sipërfaqet e pyllëzuara janë gjithsej 15 ha; Në Komunën e Novobërdës gjatë periudhës janar-dhjetorë në vendin e quajtur “Mendellakë” janë pyllëzuar me llojin e pishës së zezë (Pinus Nigra) 25000 copa fidanë me sipërfaqe 10 ha kanë punuara. Komunitat e tjera nuk kanë ofruar përgjigje lidhur me sipërfaqet e pyllëzuara.

Gjerë më tani, fushat që kanë pasur shtrirje aplikimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal në komunat tona kryesisht kanë qenë ato në projektet për infrastrukturën rrugore, ndërsa shumë pak në fusha të tjera të interesit, siç mund të jenë: Planifikimi urban, shfrytëzimi i tokës, pylltaria, shërbimet publike, administrata etj.

Projektet e realizuara

Sa i përket projekteve të realizuara si në nivel të bashkëpunimit ndërkomunal, ashtu edhe të binjakëzimeve, në periudhën raportuese janë:

- Në projektet e realizuara dhe të financuara nga fondi për zhvillim ekonomik rajonal, fond i cili menaxhohet nga MAPL, janë të përfshira 22 komuna me projekte të natyrave të ndryshme e që kapin shumën në vlerë prej 500.760.00 €.

Në vijim është paraqitur tabela me projektet e realizuara dhe të financuara nga Fondi për Zhvillim Rajonal:

MAPL dhjetor 2013		TABELA E PROJEKTEVE QE DO TE FINANCOHEN NGA FONDI PËR ZHVILLIM EKONOMIK RAJONAL-2013							
NR.	AZHR	KOMUNA LIDERE	KOMUNA PARTNERE	EMRI I PROJEKTIT	VLERA E FINANCIMIT NGA MAPL	ZOTIMI I KOMUNES	KOMPANIA FITUESE DHE DATA E NENSHKRIMIT TE KONTRATES	VLERA E KONTRATES	Vërejtje
1	QENDËR	<u>Prishtina</u>	Podujeva	Përkrahja e fermerëve në bletari.	50,000.00	8,000.00	„Bleta" 30.07.2013	58,000.00	Projekti ka përfunduar
2		Glogovci	Fushe Kosove	Tregu I kafshëve	15,000.00	5,000.00	„Polluzha-M" 12.09.2013	19,962.00	Projekti ka përfunduar
3		<u>Lipjani</u>	Graçanica	Themelimi i Laboratorëve në shkollën e mesme profesionale rajonale të bujqësisë	50,000.00	8,000.00	Lot 1: „Lavdimi", Lot 2: „Biolabi" 07.08.2013	54,701.34	Projekti ka përfunduar
4		Obiliqi	Fushë Kosova	Zhvillimi I Bujqësisë Kusht për Zhvillim Ekonomik	50,000.00	23,675.39	NT „Te Ismeti" 02.08.2013	73,350.98	Projekti ka përfunduar
5	LINDJE	Parteshi	Gjilan	Zhvillimi I Bujqësisë përshpejton zhvillimin ekonomik dhe krijon vende të qëndrueshme të punës.	49,760.00	-	NPT „Haxhijaha" 13.09.2013	35,618.00	Projekti ka përfunduar
6		<u>Shterpca</u>	Ferizaj	Blerja e mekanizmit bujqësor motokultivator	36,000.00	-	NPT „Haxhijaha"		Projekti ka përfunduar
7		Kamenica	Klllokot dhe Novoberde	Përmirësimi i kushteve për zhvillim të bujqësisë dhe krijimi i vendeve të reja të punës.	70,000.00	20,000.00	NT „Burimi" Ferizaj 27.09.2013	91,410.00	Projekti ka përfunduar

8		Hani i Elezit	Kaçaniku	Ndërtimi i serave për kultivimin e perimeve në zonat rurale për zhvillim të bujqësisë në mjediset e mbrojtura.	70,000.00	26,000.00	NPT „DST Product“ Ferizaj 30.09.2013	950.00 (per cope)	Projekti ka përfunduar
9	PERËNDIM	Peja	Deçanit, dhe Junikut	Zhvillimi i turizmit malor bazuar në komunitet	70,000.00	19,866.00	N.P.N. „NPE-ING“ 19.08.2013	89,295.00	Projekti ka përfunduar
10	VERI	Vushtrri	Skenderaj	Themelimi i pikave grumbulluese të qumështit në rajonin ekonomik Veri.	40,000.00	6,750.00	NTP „Star impiante profesionale “ 12.08.2013	45,225.00	Projekti ka përfunduar

Projektet tjera të realizuara në nivel të marrëveshjeve në mes të komunave të ndryshme janë edhe këto:

I. a. Komuna e Gjilanit dhe Novobërdës

- Marrëveshje në ofrimin e shërbimeve profesionale brenda kornizës së projektit “Përgatitja e studimit të fizibilitetit për krijimin e zonës ekonomike të Llabjanit – Komuna e Novobërdës”, e i financuar nga CzechINVENT@Quality Kosova, nga Republika Çeke. Kjo zonë do t’i takoj Komunës së Gjilanit dhe asaj të Novobërdës do thotë do ketë bashkëpunim ndërkomunal. Projekti ka kushtuar 25.000.00 €.
 - Marrëveshje Bashkëpunimi Komuna e Gjilanit me atë të Novobërdës, lidhur me kërkesat për leje ndërtimore, lidhur me rastet që prona në të cilën do të bëhet ndërtimi atakohet nga dy komunat kadastrale, t’i trajtoj dhe zhvilloj procedurat për lëshimin e lejes ndërtimore.
 - Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Gjilanit dhe Asociacioni Franco Kosovars nga Lioni, Republika e Francës, kjo lidhur me realizimin e projekteve të përbashkëta mbi bazën e donacioneve nga donatorët vendor dhe ata ndërkombëtar.
- II. Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Komunës së Vitisë dhe asaj të Kllokotit, lidhur me transferin e tërë dokumentacionit sa i përket arkivit – zonave kadastrale, tatimin në pronë, shfrytëzimin e tokës, planifikimin urban dhe gjendjen civile.
- III. Komuna e Kamenicës ka lidhur marrëveshje binjakëzimi me Komunën Gursu, Republika e Turqisë.
- IV. Komuna e Suharekës ka lidhur Marrëveshje Binjakëzimi me Komunën Lilburn (Georgia – SHBA).
- V. Komuna e Pejës ka lidhur Marrëveshje Binjakëzimi me Komunën Johnston dhe Loëa të RF të Gjermanisë.
- VI. Komuna e Klinës ka lidhur Marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Malishevës lidhur me projektin Rrugë në mes të fshatrave Sferk – Bubël.
- VII. Komuna e Klinës ka lidhur Marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Istogut mbi ndërtimin e pendës dhe kanalit të ujitjes në fshatin Rudicë.
- VIII. Komuna e Deçanit ka lidhur Marrëveshje të Binjakëzimit me Komunën e Plavës, Republika e Malit të Zi.

Nga gjithsej 38 komuna, 12 prej tyre nuk janë të përfshira me aktivitete të bashkëpunimit dhe financimit me komunat brenda vendit, por as të binjakëzimeve me ndonjë komunë jashtë shtetit të Kosovës.

E ato komuna janë: Dragashi, Gjakova, Leposaviqi, Mamusha, Mitrovica Jugore, Prizreni, Rahoveci, Shtime, Zubin Potoku, Zveçani, Mitrovica e Veriut dhe Ranillugu.

Pas gjithë kësaj vlen të theksohet se përpjekjet e MAPL-së për promovimin e bashkëpunimit mes komunave të Republikës së Kosovës janë realizuar në nivel relativisht të mirë, ndërsa mbetet për detyrë që marrëveshjet e karaktereve të tilla të realizohen në nivel edhe më të ngritur në vitet në vijim.

Sa i përket krijimit të një databaze, shumë pak komuna i janë përgjigjur kërkesës së MAPL-së në lidhje me formimin e kësaj baze së të dhënave, përmes së cilës do të krijohet një pasqyrë e qartë lidhur me gjendjen e gjertanishme të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkomunal dhe binjakëzimeve.

Ne lidhje me këtë, komunat do të obligohen të caktojnë një zyrtar përgjegjës, i cili do të bashkëpunojë me administratën qendrore në lidhje me bashkëpunimin ndërkomunal dhe binjakëzime, për qasje dhe disponim me dokumentacion të plotë, bashkëpunimin me AZHR-të përkatëse të rajonit, si dhe aktivitete tjera që ndihmojnë këtë fushëveprim.

IV. FINANCAT LOKALE

Në përputhje me politikat ekonomike shtetërore dhe duke pasur parasysh nevojën për qëndrueshmëri fiskale, Komunitet e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare, me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme. Burimet financiare komunale duhet të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Financimi i Komunal është pjesë përbërëse e KASH-it, dokument i cili është udhëzues i bazuar në deklarin e prioriteteve strategjike të Qeverisë. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave, si dhe pjesëmarrja bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

Burimet financiare të një komune përbëhen nga: të hyrat vetanake të komunës, grantet operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga Republika e Serbisë dhe të hyrat nga huamarrjet e komunës. Komunitet duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë gjatë disponimit me këto burime financiare. Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mblihen nga taksat, tarifat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkëpagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhëna të rëndësishme për shpenzimet e buxheteve komunale me vitin 2013, planifikimet buxhetore dhe niveli i mbledhjes së të hyrave gjatë vitit 2013, si dhe opinionet e auditimit për komunitet e Republikës së Kosovës për vitet 2011 dhe 2012 si kusht për huamarrjen komunale

4. Shpenzimet e buxheteve komunale për vitin 2013

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunitet e Republikës së Kosovës për vitin 2013 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 381,718,461.61€ ose 91% e buxhetimit në vlerë prej 421,340,178.99 €.

Viti 2013 tregon një rritje të buxhetit të komunave për 16,034,695.11€ ose 3.96% krahasuar me vitin 2012 (viti 2013 - 421,340,178.99€, ndërsa viti 2012 - 405,305,483.88 €).


4.1. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike në përgjithësi është shpenzuar si vijon:


- **Kategoria e rrogave dhe pagave** është planifikuar në vlerë prej 199,023,701.87€, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 196,477,896.2€, ose 99%;
- **Kategoria e mallrave dhe shërbime** është planifikuar në vlerë prej 40,957,701.53€ ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 36,423,223.73€ ose 89%;
- **Shpenzimet komunale të planifikuara** në vlerë prej 9,227,558.32€ janë shpenzuar 8,658,736.52€, ose 94%;
- **Subvencione dhe transfere të planifikuara** në vlerë prej 10,870,993.70€ janë shpenzuar 10,005,397.70€ ose 92%;
- **Kategoria e shpenzimeve kapitale të planifikuara** në vlerë prej 161,260,223.57€ është shpenzuar 130,153,207.38€, ose 81%.

Nëse i krahasojmë kategoritë ekonomike atëherë shohim se:

- Kategoria e rrogave dhe pagave është shpenzuar më së shumti (99%); ndërsa më së paku është shpenzuar kategoria e shpenzimeve kapitale (81%) krahasuar me buxhetimin.
- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me buxhetimin është shpenzuar vetëm në 1 komunë 100%; në 24 komuna prej 90 – 99%; në 7 komuna nga 80 -89%; në 3 komuna prej 70 – 79%; 3 komuna kanë shpenzuar me pak se 70% të buxhetimit . Vlen të theksohet komuna e Leposaviqit me shpenzim minimal prej 5% të buxhetimit.
- Kategoria e rrogave dhe pagave krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 8 komuna 100%; në 28 komuna është shpenzuar 90 – 99%; në 2 komuna 80 – 89% të nivelit vjetor.
- Kategoria e Shpenzimeve Komunale krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 6 komuna 100%; në 19 komuna është shpenzuar 90-99%; në 7 komuna është shpenzuar 80– 89%; në 3 komuna 70 - 79% ; 3 komuna kan shpenzuar me pak se 40%. Ketu vlen të ceket komuna e Zubin Potokut me 2% dhe komuna e Leposaviqit me zero shpenzim të nivelit vjetor.
- Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 13 komuna 100%; në 17 komuna është shpenzuar 90–99%; në 4 komuna 60–80%; me 13% të shpenzuar është Komuna e Shtërpçës dhe 3 komuna tjera me zero shpenzim (Komuna e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveqanit).
- Kategoria e Shpenzimeve kapitale (pasuritë jofinanciare) krahasuar me planifikimin në vetëm 1 komunë është shpenzuar 100%; në 13 komuna është shpenzuar 90 – 99%; në 15 komuna është shpenzuar 80 – 89%; në 8 komuna 50 – 79%; dhe Komuna e Leposaviqit me zero shpenzim të niveli vjetor.
- Me theks të veçantë janë 7 komuna (Shtime, Rahovec, Malishevë, Klinë, Pejë, Junik, Gjilan) të cilat kane arrit të shpenzojnë me së shumti ose 97% të nivelit vjetor të planifikuar; dhe përqindja me e vogël e shpenzuar në komunën e Leposaviqit me 50%.
- 3 komunit e Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq në kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve kanë zero shpenzim të mjeteve të buxhetuara.



Histogrami 41: Shpenzimet e buxhetit nga komunat në vitin 2013



Histogrami 42: Shpenzimet e përgjithshme komunale për vitin 2013

4.2. Realizimit të hyrave vetanake për vitin 2013

Ligji për Vetqeverisje Lokale rregullon të drejtën që komunat të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale. Të hyrat vetanake komunale janë faktorë mjaft i rëndësishëm për zhvillimin të vazhdueshëm ekonomik të komunave të Republikës së Kosovës.

Planifikimi i të hyrave vetanake në vlerë prej 63,394,000.00€ për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 në vlerë prej 60,419,000.00 € është më i lartë për 2,975,000.00 €.

Mbledhja e të hyrave vetanake për vitin 2013 në vlerë prej 52,172,402.27 € krahasuar me vitin 2012 në vlerë prej 55,819,658.62 € është më i ulët për 3,647,256.35 € ose një ulje prej 10%.

4.2.1. Mbledhja e të hyrave vetanake krahasuar me planifikimin

Duke marrë për bazë të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, Komunitet e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2013 kanë grumbulluar 52,172,402.27 € të hyra vetanake, ose 82.3% nga niveli i planifikuar vjetor 63,394,000.00 €.

Të hyrat që kanë një ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë:

- Tatimi në pronë i cili gjatë vitit 2013 është inkasuar në shumë prej 16,119,339 €, që është një inkasim më i madh se në periudhën e njëjtte të vitit 2012 (14,584,118 €) dhe
- Të hyrat komunale për leje ndërtimi, ku gjatë vitit 2013 është inkasuar shuma prej 15,979,303 € që është një inkasim më i vogël se gjatë periudhës së njëjtte të vitit 2012 (19,137,565 €).

Komunitet të cilat kanë realizuar të hyra vetanake përtej planifikimit vjetor janë: Klllokot (129%); Novobërdë (120%); Graçanicë (119%); Fushë Kosovë (112 %); Ranillug (103%) dhe Obiliq (100%). Ndërsa komunitet që kanë realizuar të hyra vetanake në një shkallë shumë të ulët janë: Zveqan (4%); ZAMV (11%); Leposaviq (11%) dhe Zubin Potok (24%).

Vlen të theksohet se për kundër planifikimit të të hyrave në periudhën e parë të gjashtë muorit të vitit 2013 komunitet të cilat nuk kanë realizuar fare të hyra vetanake (Komuna e Leposaviqit, Zveçanit dhe ZAMV), gjatë periudhës së dytë të gjashtëmuorit, këto komuna edhe pse në shkallë të ulët, kanë realizuar të hyra vetanake.

Nëse shikojmë realizimin e të hyrave vetanake sipas komunave gjatë vitit 2013, atëherë shohim se më së shumti ka inkasuar të hyra Komuna e Prishtinës (21,191,028.52€); Komuna e Prizrenit

(3,559,303.87 €); Komuna Gjilanit (2,924,516.21€); Komuna e Pejës (2,716,101.36€); Komuna e Ferizajit (2,565,357.88€) dhe Komuna e Gjakovës (2,185,417.54€);

Në rritjen e vlerës së të hyrave vetanake të Komunës së Prishtinës ndikim kanë pasur të hyrat komunale për leje ndërtimi (11,949,172.00€), ndërsa në komunat tjera të theksuara më lartë ndikim ka pasur tatimi në prone. Tek Komuna e Prizrenit tatimi në pronë ka qenë 1,479,900.00€; te Komuna e Gjilanit (1,222,984.00€); Komuna e Pejës (1,083,998.00€); Komuna e Ferizajit (1,220,522.00€) dhe Komuna e Gjakovës (1,066,946.00€).

Nëse krahasojmë totalin e realizimit të hyrave vetanake të vitit 2012 me totalin e realizimit të të hyrave për vitin 2013, atëherë shohim se viti 2012 ka pasur më shumë të inkasuar (55,819,659€) se sa në vitin 2013 (52,172,402€) që d.mth. se në vitin 2012 ka pasur më shumë inkasim për 3,647,256 €. (shih realizimi i të hyrave vetanake të komunave sipas strukturës për vitin 2013).

4.3. Opinionet e auditimit për komunat e Republikës së Kosovës për vitet 2011 dhe 2012 si kusht për huamarrjen komunale

Opinionet e auditorit janë të ndryshme sipas viteve. Opinioni i cili më së shumti është dhënë në vitet 2011 dhe 2012 është Opinion pa rezerve (pa kualifikuar) me Theksim të çështjes i cili u është dhënë 20 komunave. Pastaj është dhënë opinioni me theksim të çështjes në 14 komuna, opinionin me rezervë në 11 komuna, opinionin pa rezervë në 8 komuna, opinionin me rezervë me theksim të çështjes në 7 komuna, mohim të opinionit kanë marr 6 komuna dhe bazë për një opinion me rezervë me theksim të çështjes ka marr një komunë.

4.3.1. Përmbledhje e opinioneve të Auditorit Gjeneral për komunat

Opinioni i auditorit	Vitet	Komunat
Opinion pa rezerve (i pa kualifikuar)	2011	Ranillug, Prizren, Pejë, (3 komuna)
	2012	Ranillug, Suharekë, Shtime, Podujevë, Lipjan, (5 komuna)
Opinion me rezerve (i kualifikuar) me Theksim të çështjes	2011	Viti, Mamushë, Malishevë, Kamenicë, Dragash, (5 komuna)
	2012	Glllogoc, Prizren, (2 komuna)
Opinion me rezerve (i kualifikuar)	2011	Junik, Hani i Elezit, Rahovec, Obiliq, Suharekë, Shtime, Partesh, Lipjan, Klllokot, Istog, Fushe Kosovë, (11 komuna)
Mohim i opinionit	2011	Zveqan, Zubin Potok, Leposaviq, (3 komuna)
	2012	Zveqan, Zubin Potok, Leposaviq, (3 komuna)
Opinion pa rezerve (pa kualifikuar) me Theksim të çështjes	2011	Glllogoc, Vushtrri, Shtërpce, Podujevë, Novobërdë, Mitrovicë, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, (3 komuna)
	2012	Rahovec, ZAMV, Obiliq, Vushtrri, Shtërpce, Peja, Partesh, Novobërdë, Mitrovicë, Klllokot, Istog, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Prishtinë, (17 komuna)
Bazë për një Opinion me rezerve (i kualifikuar) me Theksim të çështjes	2011	Deçan, (1 komuna)
Theksim i çështjeve	2011	Kaçanik, Skenderaj, Klinë, (3 komuna)
	2012	Viti, Skenderaj, Mamushë, Malishevë, Klinë, Kamenicë, Kaçanik, Junik, Hani i Elezit, Dragash, Deçan, (11 komuna)

Tabela Nr.16. Opinionet e Auditorit Gjeneral për komunat për vitet 2011-2012

4.3.2. Përkufizimet e opinioneve sipas ISSAI 400 - Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit 400).

Një opinion auditimi normalisht është një format standard, që lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke shmangur kështu nevojën shpallur gjerësisht çfarë qëndron prapa tij por duke bartur sipas natyrës së tij një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të tij. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore e auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregojë qartë nëse është pa rezerve, me rezerve dhe nëse është rasti i këtij të fundit, nëse është me rezerve në aspekte të caktuara apo është opinion kundër (paragrafi 14), apo është refuzim (paragrafi 15).

a) Një opinion pa rezerve (i pakualifikuar) jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që: pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza dhe politika kontabël të pranueshme të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme; pasqyrat janë në pajtim me kërkesat vendase dhe rregulloret relevante; pamja e paraqitur në pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; dhe ka shpalosje të përshtatshme të të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

b) Theksimi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mund të konsiderojë se lexuesi nuk do të kuptojë siç duhet pasqyrat financiare veç nëse tërhiqet vëmendja për çështje të pazakonta apo të rëndësishme. Në parim të përgjithshëm, auditori kur jep një opinion të pa rezerve nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion me rezervë. Për të shmangur këtë përshtypje, referencat që janë menduar si “theksime të çështjeve” gjenden në paragrafë të ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdorë theksimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternative zëvendësimi opinionin me rezerve.

Auditori mund të mos jetë në gjendje të shprehë një opinion pa rezerva kur ekziston ndonjë prej rrethanave në vijim, dhe në gjykimin e auditorëve, efekti i tyre është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare: ka pasur kufizime në qëllimin e auditimit; auditori konsideron që pasqyrat nuk janë të plota apo janë çorientuese apo ekziston një largim i pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo ekzistojnë pasiguri që ndikojnë në pasqyrat financiare.

c) Opinioni me rezerve (i kualifikuar). Kur auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurtë në lidhje me një ose me tepër zëra të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo thelbësore për kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion me rezerve. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar për një pasqyrim të qartë dhe konciz, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të pasigurive që qojnë në një opinion me rezerve. Efekti i pasigurisë apo mospajtimit i dhënë në mënyrë sasiore nga auditorit ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithëse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

